



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT


QENDRA SHQIPTARE  
PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN

# RAPORTI VJETOR 2019



# 2019





# TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                                                                                                                                                                    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje .....                                                                                                                                                                                                                  | 6  |
| Përmbledhje e rezultateve .....                                                                                                                                                                                                    | 9  |
| Mobilizimi i burimeve- IPPF .....                                                                                                                                                                                                  | 15 |
| Projekti: Përparimi i parandalimit dhe kontrollit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri – IPPF .....                                                                                                                          | 18 |
| Projekti: YSAFE për rritjen e kapaciteteve të advokimit – IPPF .....                                                                                                                                                               | 21 |
| Projekti: Fol me zë të lartë: Veprime të përbashkëta për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur dhunës seksuale dhe me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në rrezik të zonave rurale duke përfshirë ato rome dhe egjiptiane ..... | 23 |
| Projekti: Ofrimi – mundësimi i edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) - Të rinjtë në Shqipëri janë të fuqizuar të realizojnë shëndetin, mirëqenien dhe dinjitetin e tyre – IPPF .....                                            | 26 |
| Projekti: Le të sfidojmë stigmën ndaj abortit dhe të ndërmarrim veprime – IPPF .....                                                                                                                                               | 29 |
| Projekti: Përshkallëzimi i përgjigjes ndaj HIV në Shqipëri – IPPF .....                                                                                                                                                            | 31 |
| Projekti: Mbrojtja e së drejtës për një jetë të lirë nga detyrimi seksual, kërcënimi dhe dhuna – IPPF .....                                                                                                                        | 33 |
| Projekti: YATAS- Aktivizmi rinor për të luftuar stigmën ndaj abortit – IPPF .....                                                                                                                                                  | 36 |
| Projekti: Advokim dhe partneritetet për të drejtat riprodhuese dhe reduktim i pabarazive të të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues – UNFPA .....                                                                          | 39 |
| Projekti: Qasje e barabartë në shërbimet e integruara të shërbimeve riprodhuese (ShR) me cilësi - UNFPA .....                                                                                                                      | 41 |
| Projekti: Dhuna me bazë gjinore dhe barazia gjinore, adresuar përmes përgjigjes shumësektoriale - UNFPA .....                                                                                                                      | 44 |
| Projekti: Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri – BE .....                                                                                                                                                    | 49 |
| Projekti: Polici në shërbim të komunitetit për trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në Bashkinë Lezhë – SIDA .....                                                                                                       | 53 |

## LISTA E AKRONIMEVE

|        |                                                        |
|--------|--------------------------------------------------------|
| BE     | Bashkimi European                                      |
| DhBGJS | Dhuna me bazë gjinore dhe seksuale                     |
| DhF    | Dhuna në familje                                       |
| ESGj   | Edukimi Seksual Gjithpërfhirës                         |
| HPV    | Human Papiloma virus                                   |
| ICPD   | Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin |
| IEK    | Informim Edukim Komunikim                              |
| IPPF   | Federata Ndërkombëtare e Planifikimit Familjar         |
| IST    | Infeksione Seksualisht të transmetueshme               |
| IShP   | Instituti i Shëndetit Publik                           |
| KSh    | Kujdesi Shëndetësor                                    |
| LGBT   | Lesbikë, gay, biseksual, transgender                   |
| MISP   | Paketa minimale e shërbimit fillestar                  |
| MSM    | Meshkujt që bëjnë seks me meshkuj                      |
| MShMS  | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale         |
| MB     | Mobilizmi i burimeve                                   |
| OSHC   | Organizatat e shoqërisë civile                         |
| OJF    | Organizata jo-fitimprurëse                             |
| OSFA   | Fondacionin e Shoqërisë së Hapur Shqipëri              |
| PF     | Planifikimi familjar                                   |
| PK     | Popullata Kyce                                         |
| PWID   | Personat që injektojnë drogë                           |
| QKB    | Qendra Kombëtare Burimore                              |
| QShPZh | Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin         |
| SIDA   | Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar             |
| ShSR   | Shëndeti Seksual dhe Riprodhues                        |
| ShMR   | Shërbimet miqësore për të rinjtë                       |
| UPR    | Raporti periodik universal                             |
| UNFPA  | Fondi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri               |
| YATAS  | Aktivizmi rinor për të luftuar stigmën ndaj abortit    |

Gjatë vitit 2019, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh) vazhdoi punën për përmbushjen e qëllimit, synimeve dhe objektivave si organizatë me kontribute në përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

## Përmbledhje

Puna e QShPZh-së gjatë vitit 2019 u përqendrua në zbatimin e 14 projekteve me fokus mobilizimin e burimeve; përparimin e parandalimit dhe kontrollit të kancerit të qafës së mitrës; rritjen e kapaciteteve të advokimit; veprime të përbashkëta për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës seksuale dhe me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në rrezik të zonave rurale duke përfshirë ato rome dhe egjiptiane; ofrimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj); sfidimin e stigmës ndaj abortit; përshkallëzimin e përgjigjes ndaj HIV; mbrojtjen e së drejtës për një jetë të lirë nga detyrimi seksual, kërcënim dhe dhuna; aktivizmin

rinor; advokimin për të drejtat riprodhuese dhe reduktimin e pabarazive të të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues; qasjen e barabartë në shërbimet e integruara të shërbimeve riprodhuese (ShR) me cilësi; dhunën me bazë gjinore dhe barazinë gjinore, adresuar përmes përgjigjes shumësektoriale; Qendrën Kombëtare Burimore për shoqërinë civile në Shqipëri dhe policinë në shërbim të komunitetit për trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës.

Një nga ngjarjet që vlen të veçohet, është pjesëmarrja e dy anëtarëve të stafit të QShPZh-së në Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD), Samiti +25, që zhvilloi punimet në Nairobi. Në këtë samit, Drejtoresha Ekzekutive e QShPZh-së paraqiti dy nga angazhimet kryesore të organizatës: 1) Advokimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) për përmirësimin e ligjit nr. 8876, datë 04.04.2002, “Për shëndetin riprodhues”, në mënyrë që të sigurohet mbulimi i përgjithshëm i shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR), veçanërisht për komunitetet me mundësi të pakta. 2) Ofrimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) për 50000 të rinj në të gjithë Shqipërinë, brenda dhe jashtë shkollës, përmes edukimit formal dhe joformal, përfshirë qasjet inovative dhe digjitale. QShPZh-ja ka planifikuar aktivitete të ndryshme për të ndjekur angazhimet e qeverisë, advokime në kuadrin e planeve të përbashkëta vjetore ndërmjet IPPF-së, UNFPA-s dhe organizatës, siç janë: seancat dëgjimore me deputetë, tryezat e rrumbullakëta, fushatat e advokimit me vendimmarrësit etj.



Programi Kombëtar i Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, që filloi në vitin 2019, bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 30.01.2019, “Për miratimin e paketës së Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në Shqipëri”. Ky program vjen pas disa vitesh advokimi dhe ndërgjegjësimi të QShPZh-së në bashkëpunim me aktorët kryesorë dhe me mbështetjen e IPPF-së dhe UNFPA-së. Programi kombëtar i depistimit synon gratë 40-50 vjeçe. Qëllimi është që t’u mundësojë të gjitha grave të kësaj grup-moshe teste ekzaminuese HPV, si pjesë e ekzaminimeve rutinë të bëra në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, si dhe ndjekje të specializuara për të gjitha rastet me rrezik të lartë.

Gjatë vitit 2019, QShPZh-ja ndërmori nismën advokuese për identifikimin e mangësive në ligjin për shëndetin riprodhues, të miratuar në vitin 2002, dhe për përcaktimin e fushave për përmirësim. Si rezultat i punës së vazhdueshme të advokimit, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxori Urdhrin Nr. 716, datë 28.10.2019, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e ndryshimeve të ligjit nr. 8876/2002, “Për shëndetin riprodhues”, i ndryshuar”. Grupi teknik përbëhej nga përfaqësues të institucioneve shëndetësore përgjegjëse që mbulojnë ShSR-në për të rishikuar ligjin.

Udhërrëfyesi i shërbimeve miqësore për të rinjtë (ShMR) është miratuar nga MShMS-ja në vitin 2016. Në vitin 2019, QShPZh-ja, me mbështetjen e UNFPA-s dhe IPPF-së, punoi për rishikimin e këtij dokumenti. Në vitin 2020, QShPZh-ja do të advokojë për zbatimin e udhërrëfyesit në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor.

Në vitin 2020, QShPZh-ja do të vazhdojë punën advokuese në lidhje me miratimin e paketës minimale të shërbimit fillestar (MISP); procedurat standarde të operimit për dhunën me bazë gjinore (përfshirë procedurat në situatat humanitare); përfshirjen dhe disponueshmërinë e mjeteve për ShSR-në në situata emergjente dhe krizash në plan kombëtar; ofrimin e ESGj-së grupeve vulnerabile përmes mundësimi të fondeve për OJF-të; dekriminalizimin e të gjitha aspekteve të shfrytëzimit seksual me dhunë nga të rritur dhe transmetimit të HIV; rritjen e shpenzimeve për shëndetin publik dhe akordimin e një buxheti të mjaftueshëm për kujdesin ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues.

Gjatë vitit 2019, QShPZh-ja trajnoi 200 të rinj si edukatorë bashkëmoshatarë në ESGj; 120 të rinj u pajisën me serinë e plotë të kurrikulës së ESGj-së; 810 të rinj me një seri të pjesshme të kurrikulës së ESGj-së; 320 me seanca të vetme; 200 edukatorë u trajnuan për të ofruar ESGj-në tek të rinjtë dhe 125 të tjerë për të ofruar trajnime për ESGj-në për edukatorët e tjerë. 90 anëtarë të komunitetit u ndërgjegjësuat për përfitimet e ESGj-së për jetën e të rinjve. 2450 të rinj dhe të rritur ndoqën shfaqje teatrale, blogun për adoleshentë dhe fushatat në mediat sociale me mesazhe pozitive për ESGj-në. Duke përdorur në mënyrë aktive mediat sociale, përfshirë blogun, u rrit me 30% numri i ndjekësve të faqes sonë të Facebook-ut.

Nevojat prioritare të ngritura nga gratë anëtare të katër forumeve gjatë mbledhjeve të këshillave bashkiakë (forume të pavarura të grave të përbëra nga qytetarë aktivë në kuadër të një nisme të mbështetur nga Olof Palme 2014-2016), me seli në 4 zona rurale të Vlorës, u përfshinë në buxhetin lokal 2020. Ndër prioritetet përfshihen: kopshte falas, transporti



falas për të ndjekur kurset profesionale falas për 35 gra të zonave rurale, përfshirë viktimat e dhunës në familje (përmes një buxheti të dedikuar prej 80000 \$).

30000 individëve u janë dërguar mesazhe pozitive për ShSR-në përmes katër kanaleve të komunikimit: online, offline, mediave të jashtme dhe shpërndarjes te partnerët.

819 ofrues të shërbimeve të ShSR-së u trajnuan nga QShPZh-ja gjatë vitit 2019 për shërbimet miqësore për të rinjtë; për metodat kontraceptive; për shërbimet dhe metodat e kontracepsionit të përkohshëm me veprim të shkurtër, shërbime të lidhura me ndërprerjen e shtatzënisë; për shërbime të kontrollit/parandalimit ose trajtimit të kancerit të qafës së mitrës; për shërbimet e kontrollit dhe/ose këshillimit për dhunën me bazë gjinore dhe për shërbimet për infeksionet seksualisht të transmetueshme/sëmundjet seksualisht të transmetueshme (IST/SST).

36666 shërbime të ShRS-së u janë ofruar 10480 klientëve përmes klinikave, shërbimeve të bazuara në komunitet dhe klinikave të lëvizshme.

180 vullnetarë dhe 372 aktivistë u përfshinë në planifikimin e aktiviteteve të QShPZh-së, në zbatimin, monitorimin e vlerësimin, në mbledhjen e fondeve, në qeverisje dhe vendimmarrje.

8 grupe të të rinjve dhe grave ndërmorën të paktën një veprim publik për të mbështetur ShSR-së.

Mjedisi i financimit për të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues është duke u përkeqësuar, veçanërisht pas largimit të shumë donatorëve tradicionalë në çështjet e planifikimit familjar (PF) disa vjet më parë. Mobilizimi i burimeve të organizatës synon të eksplorojë mundësi të reja financimi, të ushqejë marrëdhëniet me donatorët ekzistues dhe të rrisë kapacitetet e aftësitë e stafit të saj. Është hartuar një plan i ri për zhvillimin e këtyre burimeve. QShPZh-ja do të vazhdojë të riformatojë mesazhet për të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, në mënyrë që bashkësia e donatorëve të ndihmojë në sigurimin e të drejtave dhe kujdesin për të gjithë.





# PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

## Rezultati 1: Kampionët e të drejtave

- Forcimi i aleancave dhe partneriteteve strategjike me koalicionin e ShSR-së, me rrjetin e monitorimit të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, Rrjetin e Zërit të të Rinjve dhe me grupet e grave dhe të rinjve për advokimin e shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR).
- Riformatimi i mesazheve të ShSR-së për të përcjellë sa më qartë rëndësinë dhe vlerat që ka edukimi shëndetësor, në mënyrë që komuniteti i donatorëve të ndihmojë në sigurimin e të drejtave dhe kujdesin për të gjithë.
- Pjesëmarrja në konsultime (si ekspertë në ShSR) për rishikimin e ligjit të shëndetit riprodhues, në Samitin ICPD +25, për të ndikuar në përmirësimin e ligjit për ShSR-në, të politikave publike dhe programeve qeverisëse.
- Ndikimi i forumeve të grave në planifikimin e buxhetit lokal përmes pjesëmarrjes në takimet e këshillit bashkiak.
- Advokimi i përbashkët me dhe/ose mbështetje të advokimit të tetë grupeve të grave dhe të rinjve për ShSR-në, gjininë dhe/ose zhvillimin e qëndrueshëm (përmes deklaratave publike, pozicionimit, fushatave dhe veprimeve publike).
- Pjesëmarrja në seancat parlamentare të komisioneve dhe nënkomisioneve të ndryshme, siç janë Komisioni Parlamentar për Punë, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Aleanca për Gratë Parlamentare; Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, dhe ngritja e zërit për çështjet në lidhje me ShSR-në.
- Ngritja e kapaciteteve të grupeve të grave si Forumi i Gruas në Vlorë dhe të rinjve dhe aktivistëve të tre qendrave të QShPZh për të qenë liderë dhe advokues për shëndetin seksual dhe riprodhues.

## Praktikat më të mira

Këtë vit, QShPZh-ja ndërmori nismën advokuese (me mbështetjen e anëtarëve të bordit të saj këshillimor) për identifikimin e mangësive në ligjin për shëndetin riprodhues, të miratuar në vitin 2002, dhe fushat për përmirësim. Për këtë, u hartua një përmbledhje e legjislacionit, dokumenteve strategjike dhe konventave ndërkombëtare të



nënshkruara nga shteti në lidhje me ShSR-në, si dhe u zhvilluan takime konsultative me grupet kryesore të interesit, me partnerët, me OShC-të dhe me gratë e të rinjtë aktivistë të të drejtave të njeriut.

Rekomandimet kryesore që lidhen me nevojat e identifikuara tashmë prej vitesh nga QShPZh-ja, përfshijnë miratimin e akteve nënligjore për: edukimin shëndetësor; kujdesin para dhe pas lindjes; investimet në infrastrukturë; edukimin për shëndetin riprodhues si pjesë e platformave të komunikimit; koordinimin e mirë për kujdesin shëndetësor dhe efektivitetin në të gjitha nivelet që lidhen me referimet; mbledhjen e të dhënave dhe ndarjen sipas gjinisë; programe kombëtare për shfaqjen e kancerit; integrimin e testimit të HIV brenda paketës parësore të KSh-së; studime të ndryshme mbi demografinë dhe ShR-në; mekanizma të qartë për të monitoruar zbatimin e ligjit etj. QShPZh-ja vlerëson si të rëndësishëm organizimin e takimeve të nivelit të lartë me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me drejtorin e përgjithshme për politikën në MShMS për të siguruar mbështetjen e kësaj nisme nga ministria. Në tetor u dërgua në MShMS një memorandum me arsyetimin për rishikimin e ligjit për ShR-në. Nxjerrja e Urdhrit të MShMS-së Nr. 716, datë 28.10.2019, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e ndryshimeve të ligjit nr. 8876/2002 “Për shëndetin riprodhues”, i ndryshuar”, është rezultat i punës sonë të vazhdueshme të advokimit.



## Rezultati 2: Komunitete të fuqizuara

- Trajnimi i trajnerëve, edukatorëve, vullnetarëve ndërmjetës dhe i punonjësve të terrenit për të ofruar edukimin seksual gjithëpërfshirës.
- Mbështetja e sektorit publik për të ofruar ESGj-në.
- Ofrimi i ESGj-së për të rinjtë në shkollë dhe jashtë saj.
- Zhvillimi dhe zbatimi i qasjeve të reja për ofrimin e ESGj-së joformal.
- Përdorimi i medias për të promovuar shëndetin, zgjedhjet dhe të drejtat e individëve (përmes ngjarjeve, fushatave dhe zhvillimit të blogut për të rinjtë).
- Përdorimi i kanaleve dhe materialeve komunikuese, si: faqja zyrtare e internetit e QShPZh-së, publikimet në media sociale etj., për të promovuar shëndetin, zgjedhjen dhe të drejtat e individit.

- Kapacitete të ngritura të QShPZh-së në media dhe komunikim.
- Organizimi i fushatave/ngjarjeve, mbulimi nga mediat për nxjerrjen në pah të mbështetjes nga personalitete të famshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës.

### **Praktikat më të mira**

Në kuadër të projektit “Ofrimi – mundësi i edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) - Të rinjtë në Shqipëri janë aftësuar të kujdesen për shëndetin, mirëqenien dhe dinjitetin e tyre”, QShPZh-ja trajnoi 120 nxënës si edukatorë të bashkëmoshatarëve për ESGj-në në shkollat e Tiranës, Vlorës, Shkodrës, Durrësit, Lezhës dhe Elbasanit.

Si rezultat i trajnimeve, nxënësit u pajisën me njohuri dhe aftësi për ESGj-në, për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat e tyre, për të shmangur abuzimin seksual dhe dhunën e për të ngritur marrëdhënie të respektueshme me të tjerët. Ata e kanë ndarë informacionin me 720 të rinj të tjerë të shkollave dhe grupeve në nevojë.

600 të rinj, nga 3910 që janë përfshirë në ESGj (sesione, shkolla ESGj, blogu, fushata në media sociale), kanë marrë të paktën një shërbim nga klinikat e QShPZh-së, nga ofrimi i shërbimit në komunitet dhe nga klinikat e lëvizshme, si dhe janë referuar në klinikat e QShPZh-së që ofrojnë shërbime miqësore për të rinjtë sipas nevojës. 200 prej 600 të rinjve ishin nga popullata kyç, përfshirë ata që injektojnë drogë, meshkuj që bëjnë seks me meshkuj dhe LGBT, ndërsa 400 të rinjtë e tjerë nga zonat rurale e urbane, nga pakica rome etj.

Programi i edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) i cili është zhvilluar bazuar në “Është e gjitha një kurrikul” e Federatës Ndërkombëtare të Planifikimit Familjar (IPPF), ka një kapitull të ndarë dedikuar dhunës me bazë gjinore dhe seksuale (që përfshin tema si dhuna; të qënurit i shtërit dhe përdorimi i sigurtë i teknologjisë së informacionit). Moduli është rishikuar në 2018 dhe ndër përmisimet e reflektuara janë përfshirë shumë specifkime rreth mekanizmit të referimit lidhur me DhBGjS, përfshirë institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, sektori jo fitimprurës dhe njësitë lokale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Programi u mundësoi pjesëmarrësve të rinj njohuri dhe aftësi gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe përgjigjen e DhBGjS.

Dy raste të ngacmimeve seksuale janë raportuar nga shkollat e zonave rurale, në të cilat QShPZh-ja ka ofruar ESGj-në. Të rinjtë njoftuan mësuesit kujdestarë dhe raportuan për ngacmimet. Mësuesit ndoqën procedurën sipas rregullores së shkollës, duke i raportuar drejtorit, dhe u ndërmorën masa të mëtejshme për hetim, pasi u kërkuar menjëherë ndërhyrja e Policisë së Shtetit. Të dy nxënësve iu ofruan sesione këshillimi nga psikologjia e shkollës. Gjithashtu, mësuesit kanë vënë theksin fort në të drejtat e fëmijëve dhe në parandalimin e ngacmimit seksual gjatë ofrimit të ESGj-së në shkollë. Prindërit janë këshilluar nga drejtoria e shkollës dhe nga psikologët për mbështetje emocionale ndaj fëmijëve.

50 vullnetarë të rinj u janë bashkuar programeve të QShPZh-së pas pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e ndryshme të projektit për ESGj-në.

### **Rezultati 3: Shërbime për popullatën**

- Forcimi dhe zgjerimi i partneritetit për ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat përfshirë kompani farmaceutike, fabrikat, industrinë (ofrimi i materialeve, trajnimeve etj.).
- Forcimi dhe zgjerimi i trajnimeve për ofruesit e jashtëm të shërbimeve.
- Ofrimi i shërbimeve bazuar në të drejtat, përfshirë abortin e sigurt dhe HIV.
- Mundësimi i shërbimeve përmes ofruesve të shëndetit publik dhe privat.

### **Praktikat më të mira**

36666 shërbime të ShSR-së u janë ofruar 10480 klientëve përmes klinikave, shërbimit në komunitet dhe klinikave të lëvizshme.

QShPZh-ja ka vijuar punën për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Këtu përfshihen:

- 48 ofrues të kujdesit shëndetësor përfunduan trajnimin online për planifikimin familjar.
- 541 ofrues të kujdesit shëndetësor nga 400 qendrat shëndetësore në të gjithë vendin janë trajnuar për të përgatitur qendrat e kujdesit shëndetësor parësor dhe sistemin e shëndetit publik për zbatimin e Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës.
- 65 ofrues të kujdesit shëndetësor ndoqën trajnimin dyditor “Mbi zhvillimin ose përshtatjen e udhëzuesve klinikë për shërbimet e ShSR-së”.
- 22 ofrues të kujdesit shëndetësor u trajnuan për ofrimin e shërbimeve në situata emergjence dhe në mjedise humanitare.
- 47 ofrues të kujdesit shëndetësor ndoqën dy trajnimet dyditore për ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë ndaj gjinisë të ndjeshme dhe pa stigma ndaj abortit për të gjitha gratë dhe vajzat.
- 24 ofrues të kujdesit shëndetësor morën pjesë dhe përfunduan me sukses trajnimin dyditor me temë “Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor nga perspektiva e të drejtave njerëzore fokusuar në komunitetin LGBT”, bazuar në draftkurrikulën e grupit të ekspertëve të QShPZh-së.
- 52 ofrues të kujdesit shëndetësor përfunduan dy trajnime dyditore për shërbimet shëndetësore të HIV/AIDS pa stigma dhe diskriminim.
- 30 ofrues të kujdesit shëndetësor dhe kujdesit social morën pjesë në seminarin njëditor për kalimin e suksesshëm të të rinjve me çrregullime mendore apo përdorues substancash nga burgu në komunitet.

Sigurimi i shërbimeve të integruara të ShSR-së përmes klinikave të QShPZh-së dhe trajnimit i ofruesve të kujdesit shëndetësor mund të konsiderohen si praktikat më të mira, sepse

sektori i shëndetësisë po përballët me sfida të mëdha, pasi doktorë e mjekë të specializuar vazhdojnë të migrojnë jashtë vendit, ndërkohë që një punonjësi që shërben në sistemin e kujdesit shëndetësor, i mungojnë aftësitë e nevojshme për të ofruar promocion dhe shërbime cilësore të ShSR-së.

Raporti i Progresit për Shqipërinë i Komisionit European për vitin 2018 nënvizoi se: *“Për të ulur pabarazitë shëndetësore, duhet të forcohet qasja në shërbime për popullatat e cënueshme, përfshirë gratë, romët dhe pakicat egjiptiane, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe popullsinë në zonat rurale ose të largëta”.*

Qasja në shërbime pengohet nga sjelljet joprofesionale, të njëanshme dhe diskriminuese të personelit dhe stafit në qendrat e kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, fondet për promovim, ndërgjegjësim dhe përfshirje të komunitetit janë ende shumë të ulëta.

Të gjitha trajnimet janë akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim duke u dhënë mundësi mjekëve dhe infermierëve të fitojnë një numër kreditesh që janë të detyruara për secilin vit, në mënyrë që të ruajnë vendin e punës.

#### **Rezultati 4: Bashkimi dhe performanca**

- Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe i planeve të veprimit për shfrytëzimin e burimeve të përshtatshme (përfshirë zgjerimin e hartës së donatorëve).
- Mobilizimi i burimeve për të zgjeruar bazën e fondeve.
- Forcimi financiar (rritja e buxhetit - ulja e kostos).
- Forcimi i qeverisjes.
- Përmirësimi i menaxhimit të njohurive.
- Rritja e kapaciteteve të QShPZh-së për mobilizimin e burimeve.
- Forcimi i kapacitetit të menaxhimit.
- Identifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve për të angazhuar aktivistë.
- Rritja e kapaciteteve të aktivistëve për çështjet e ShSR-së.

#### **Praktikat më të mira**

Në kuadër të projektit YATAS, rreth 2609 të rinj u aftësuan përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, siç janë: trajnimet, sesionet informuese, panairët e të rinjve, eksperimentet sociale, emisionet në radio, ndërgjegjësimet publike, materialet e IEK-së (informim - edukim - komunikim) dhe postimet në Facebook.

- 42 të rinj (27 prej tyre nga Fakulteti i Mjekësisë) ishin pjesë e trajnimit të bashkëmoshatarëve. 80% e tyre janë, tashmë, anëtarë të QShPZh-së dhe 35% e tyre janë pjesëmarrës aktivë të



projekteve dhe aktiviteteve të QShPZh-së.

- 250 persona u përfshinë në eksperimentin social bazuar në pjesëmarrësit në panair dhe në materialet e shpërndara të IEK-së, të cilat ishin pjesë e eksperimentit social.
- Nga 2609 të rinj të përfshirë në aktivitete, 1800 janë vajza. 340 janë nga pakica rome dhe gati 200 prej tyre janë vajza të moshës 14-29 vjeç.
- 35 për qind e të rinjve janë nga zonat rurale të Qarkut të Tiranës.
- 500 materiale të IEK-së u ndanë midis të rinjve.

Duke marrë parasysh stigmën dhe diskriminimin që rrethon abortin në Shqipëri në të gjitha nivelet, politikat, ofruesit e kujdesit shëndetësor, median, komunitetin dhe individët, është shumë e rëndësishme të edukohen të rinjtë brenda dhe jashtë shkollës për abortin nga perspektiva e një të drejte njerëzore. Është thelbësore për t'u nënvizuar se të gjitha normat negative sociale që i pengojnë gratë të ushtrojnë të drejtat e tyre, janë shtrënguese dhe kërcënim për të drejtat riprodhuese dhe shëndetin e grave. Pajisja e të rinjve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ShSR-në, përfshirë abortin, i përgatit ata për një shëndet dhe të ardhme më të mirë.

# Projekti: Mobilizimi i burimeve – IPPF EN

## Arritjet e projektit

- Një nivel më i lartë fondesh të QShPZh-së këtë vit për shpërndarjen e programeve të saj, në përputhje me katër qëllimet e planit strategjik të organizatës dhe kornizës strategjike të IPPF-së që mbulon edukimin seksual gjithëpërfshirës dhe ndërgjegjësimin, ndërtimin e kapaciteteve, advokimin e bazuar në prova për ShR-në, popullsinë dhe zhvillimin, përfshirë HIV, abortin, dhunën me bazë seksuale dhe gjinore, kancerin e qafës së mitrës, gjininë dhe të drejtat që kanë si përfitues të synuar profesionistët e kujdesit shëndetësor, partnerët, mësuesit dhe të rinjtë, vendimmarrësit, deputetët, gratë dhe burrat, anëtarët e komunitetit etj.
- Përballja e IPPF-së dhe QShPZh-së me sfida në drejtim të reformave të ndërmarra në lidhje me shpërndarjen e burimeve dhe qeverisjen. Pavarësisht kësaj, QShPZh-ja ka pasur rritje me 21% të fondeve krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje u bë e mundur për shkak të performancës së mirë gjatë vitit 2018-2019, anëtarësimit të saj në IPPF (mundësimi i një granti bazë), punës së palodhur të stafit dhe vullnetarëve të organizatës, të cilët vazhdojnë të kontribuojnë në standarde të larta duke ndikuar kështu pozitivisht në perceptimin e donatorëve, partnerëve dhe qeverisë për organizatën si e përgjegjshme, e besueshme dhe me reputacion.
- Përmirësimi me 7.8% i të ardhurave të krijuara nga shërbimet e qendrës “Aulona”, për shkak të punës së zgjeruar promovuese të klinikës përmes kanaleve të ndryshme, si: mjetet e komunikimit online dhe offline, profesionalizmi i stafit, cilësia e shërbimeve të ShR-së dhe konfidencialiteti i privatësisë së siguar.
- Heqja dorë e shumicës së donatorëve dypalësh nga mbështetja e tyre për programet e planifikimit familjar, ndërkohë që përdorimi i kontracepsionit modern nga gratë aktualisht të martuara ka rënë nga 11% në 2008-2009 në 4% në 2017-2018. Bazuar në këtë situatë, QShPZh-ja ka marrë një grant nga IPPF-ja për të mbështetur analizat e situatës në lidhje me përdorimin e kontracepsionit në Shqipëri dhe për të dalë me disa rekomandime për përmirësim.
- Trajnimet e QShPZh-së në lidhje me stigmën ndaj abortit, dhunën me bazë gjinore dhe edukimin seksual gjithëpërfshirës, gjininë dhe të drejtat, planifikimin strategjik,





parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, shërbimet e HIV për komunitetin LGBT nga një qasje e bazuar në gjini dhe të drejtat e njeriut, shërbime miqësore për të rinjtë (të ofruara nën PV 2019, UNFPA ose organizata të tjera). Në këto trajnime, stafi, anëtarët e bordit dhe vullnetarët janë pajisur me aftësi të nevojshme për të prezantuar dhe shpërndarë si duhet programet e QShPZh-së dhe për të përçuar sa më qartë rëndësinë e ShR-së. Të gjitha këto tregojnë vlerat morale të punës sonë.



- Përfshirja e 180 vullnetarëve dhe 372 aktivistëve në aktivitetet e QShPZh-së për planifikimin, zbatimin e rasteve të advokimit, monitorimin dhe vlerësimin, mbledhjen e fondeve, qeverisjen dhe vendimmarrjen.
- Realizimi i një strategjie dhe një plani veprimi të ri për mobilizimin e burimeve (2019-2021) përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje, i cili përfshinte një seminar dyditor me stafin dhe vullnetarët, si dhe takime konsultimi me partnerët dhe palët kryesore të interesit.
- Thirrja për aplikime si një mekanizëm për mundësi financimi të përdorura gjerësisht nga QShPZh-ja në vitin 2019. Ka filluar projekti trevjeçar “Qendra Kombëtare Burimore për organizatat e shoqërisë civile”, nën drejtimin e një partneri lokal, “Partnerët Shqipëri” me fonde nga BE. Projekti do të vazhdojë deri në vitin 2021 dhe ka një buxhet prej 81141 EUR për QShPZh-në si partner zbatues. Sipas këtij projekti, zyra e Shkodrës ka rifilluar aktivitetin e saj dhe mbulohet ndarja e stafit për dy koordinatore të Shkodrës dhe Vlorës.
- Ngjarje të ndryshme me një audiencë të madhe, si Konferenca për Rishikimin Periodik Universal, një forum me burra “Djemtë e burrat që frymëzojnë”, konsultime për nevojën e rishikimit të ligjit për shëndetin riprodhues, aktivitete për ngritjen e vetëdijes, programe në TV dhe radio, website i QShPZh-së dhe media sociale. Të gjitha këto janë përdorur si mjet për arsimimin, ngritjen e vetëdijes dhe/ose advokimin për përfituesit e synuar, duke mbajtur profilin e lartë të QShPZh-së midis partnerëve dhe donatorëve.
- Gjuha e rafinuar për të shpjeguar abortin, kontracepsionin, të drejtat e grave dhe ESGj-në, e cila ka ndikuar te personat e angazhuar që ata të shfaqin vlerat e tyre, të amplifikojnë mesazhet për të siguruar mbështetjen e partnerëve të tjerë të shoqërisë civile dhe i ka mobilizuar ata në advokimin tonë të përbashkët me audiencën e synuar, aktorët politikë etj.
- Pamundësia që QShPZh-ja të merrte teste falas për HPV nga Instituti i Shëndetit Publik, siç ishte parashikuar vitin e kaluar, sepse, sipas rregullave të MShMS-së, vetëm qendrat e kujdesit shëndetësor publik mund të ishin pjesë e Programit Kombëtar të Depistimit

falas si mënyrë për të siguruar që çdo rast pozitiv të ndiqet rreptësisht (referohet dhe/ose trajtohet).

### ***Sfidat e projektit***

- Duke marrë parasysh që tre nga 15 punonjësit e QShPZh-së janë të rinj dhe me qendër në ambientet e selisë, ende ka nevojë për shtim të mëtejshëm të kapaciteteve. Ngjarjet lokale dhe ndërkombëtare mund të jenë një mundësi për ata që të kualifikohen në fushën e ShR-së, posaçërisht në hartimin e projekteve, mbledhjen e fondeve, të folurit në publik, strategjitë e komunikimit dhe promovimin e punës së organizatës.
- Situata e viteve të fundit për financimin e brendshëm për kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues nuk ka qenë inkurajuese në Shqipëri. Mjedisi i financimit për ShSR-në është duke u përkeqësuar, veçanërisht pas largimit të shumë donatorëve tradicionalë në planifikimin familjar disa vjet më parë. Politika e kufizimit të abortit, e njohur edhe nga presidenti Trump si “rregulli global i mashtrimit”, ka ndikuar negativisht në agjendën e shëndetit seksual riprodhues dhe të drejtat në Shqipëri.
- QShPZh-ja do të vazhdojë të punojë për përfshirjen dhe angazhimin e vullnetarëve të rinj dhe anëtarëve të bordit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të ndryshme. Vullnetarët konsiderohen një vlerë e shtuar për organizatën tonë.
- Nisma e rafinimit të gjuhës do të vazhdojë të jetë e integruar në të gjitha aktivitetet e QShPZh-së, me qëllim lidhjen e ShR-së me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe zgjerimin e partneriteteve me palët e interesuara dhe donatorët kryesorë, krijimin e një agjende të përbashkët dhe bashkimit e forcave për zbatimin e saj.
- Do të përdoren strategji tërheqëse të komunikimit, përfshirë webin e QShPZh-së, mediat sociale për të promovuar shëndetin, zgjedhjen dhe të drejtat, në kuadrin e fushatave të ngritjes së vetëdijes, përkrahjen e personave të famshëm dhe krijuesve të opinioneve.
- E veçanta e strategjisë dhe e planit të mobilizimit të burimeve është se identifikohen donatorët dhe fushat/programet e tyre prioritare në lidhje me të drejtat e njeriut, ShR-në dhe dhunën me bazë gjinore (DhBGj) në kohëzgjatje prej tre vjetësh, duke përfshirë: Holandën, Bashkimin Europian, UNDP, USAID Shqipëri, Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), Ambasadën Zvicerane, Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur Shqipëri (OSFA), SIDA (Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, përmes Ambasadës Kanadeze) etj.
- Ndërkohë që klinika e Tiranës ofron shërbime falas, do të hulumtohen, gjatë vitit 2020, mënyra të mundshme për vendosjen e disa çmimeve të përballueshme për shërbimet e saj.
- Organizata do të investojë në rritjen e kapaciteteve të personelit të ri për të hartuar propozime, në mënyrë që të hulumtojë zgjidhje inovatore për mundësi fondesh. Për të gjithë stafin, QShPZh-ja do të përdorë takimet e aktivitetet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si mundësi për të përmirësuar aftësitë e personelit në afrimin e donatorëve dhe mbledhjen e fondeve.

# Projekti: Përparimi i parandalimit dhe kontrollit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri - IPPF EN

## Arritjet e projektit

- Hartimi i një kurrikuli trajnimi nga tre specialistë të Institutit të Shëndetit Publik, bazuar në një model të mëparshëm të udhëzimeve kombëtare të kontrollit të kancerit të qafës së mitrës, në kujdesin shëndetësor parësor dhe në kornizën e re teknike të programit kombëtar të depistimit për gratë 40-50 vjeçe përmes testit me rrezik të lartë HPV (me mbështetjen e UNFPA-s).
- Pajisja e 60 ofruesve të kujdesit shëndetësor, përfshirë gjinekologë, mami dhe mjekë të familjes në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, menjohuri dhe aftësi për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, me fokus në testin e vetëmarrjes së mostrave dhe ndjekjen e tyre.
- Zhvillimi i katër takimeve parashikuese me përfaqësuesit e operatorëve të kujdesit shëndetësor në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan si institucione kryesore shëndetësore rajonale, përgjegjëse për zbatimin e Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës. Si rezultat, partneritetet midis QShPZh-së dhe këtyre institucioneve të reja shëndetësore në Shqipëri (pas reformës shëndetësore në Shqipëri ekzistojnë 4 institucione të reja rajonale shëndetësore të quajtur *Operator i Kujdesit Shëndetësor*), shërbejnë për të koordinuar më mirë përpjekjet për planifikimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës.
- Kryerja e 3 vizitave monitoruese nga eksperti drejtues dhe një anëtar i stafit të QShPZh-së në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër në qendrat e kujdesit shëndetësor ku po zbatohet programi. Janë identifikuar boshllëqe dhe nevoja, të tilla si: emërimi i një personi përgjegjës për përcjelljen e testeve të dërguara në laboratorin e Institutit të Shëndetit Publik; përmirësimi i regjistrimit të kancerit të qafës së mitrës me të dhëna në lidhje me testet dhe shërbimet e ofruara nga kanceri i qafës së mitrës; bashkimi i shqyrtimit me regjistrat e trajtimit të kancerit; mirëpritja e grave për t'u testuar.



- Kontaktimi i 5500 personave, përfshirë gra elitare, me mesazhe në fushata dhe media sociale në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.
- Përdorimi i 3000 fletëpalosjeve, 4 posterave, 300 byzylykëve, 300 çantave dhe 500 kartolinave për të promovuar parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.
- Ndarja e 5 postimeve informuese në internet përmes mediave sociale dhe kontaktimi i më shumë se 2000 personave.
- Funksionimi, tani, në secilin prej 35 rretheve shëndetësore i strukturave me nga një koordinator përgjegjës (pikë kontakti). Ato monitorojnë shpërndarjen e materialeve në qendrat shëndetësore, trajtimin e mostrave vaginale dhe shpërndarjen e tyre në laboratorin kombëtar në ISHP.
- Raportimi nga Drejtoresha Ekzekutive e QShPZh-së, në një takim konsultues në emër të Samitit ICPD +25, 2019, i zbatimit të progresit të programit të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës.
- Ofrimi i 4572 shërbimeve të kancerit të qafës së mitrës, përfshirë marrjen e mostrave nga pap-teste dhe VIA, 1519 grave përmes klinikave të QShPZh-së.

### ***Disa rezultate në fund të vitit të parë të zbatimit të Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në Shqipëri***

- Gjatë vitit 2019, programi përfshiu 12300 gra të moshës 45-49 vjeçe.
- 6.1% e këtyre grave ishin pozitive për HPV me rrezik të lartë (RL-HPV) dhe kjo përbën mbizotërimin e shkallës së pozitivitetit për këtë kategori të testuar.
- Përhapja e infeksionit RL-HPV në qytet është 20% më e lartë se në fshat.
- 542 profesionistë të shëndetit (321 Infermierë dhe 221 mjekë) morën pjesë në aktivitete.
- 4 kurse trajnimi në 3 qarqe të Shqipërisë u mbështetën nga IPPF Rrjeti Europian dhe 10 trajnime në 10 rajone të tjera u mbështetën nga UNFPA.
- 4 partneritete bashkëpunuese u krijuan me Operatorin Rajonal të Shëndetësisë.

### ***Sfidat e projektit***

- Programi i parandalimit të kancerit të qafës së mitrës tani është pjesë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të ofruara çdo ditë nga qendrat e kujdesit shëndetësor në sektorin shëndetësor parësor. Çdo grua dhe vajzë ka qasje në shërbimet e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës. Viti i parë i zbatimit tregoi disa sfida që duhet të merren parasysh për të ardhmen e programit.
- Së shpejti, kërkesa do të tejkalojë ofertën për teste (kite) depistuese të plota, të cilat duhet të merren parasysh urgjentisht në planifikimin e prokurimit të kiteve nga MShMS-



ja. Në planin afatgjatë, kjo kërkesë e popullatës ndaj programit do të duhet të merret në konsideratë, ndërkohë që duhet të parashikohen, gjithashtu, burime për mbulimin e 80% të shërbimeve të depistimit.

- Sfidë përbëjnë informimi dhe rritja e vetëdijes së popullatës së grave, veçanërisht e kategorive më të marginalizuara ose më të prekshme, ku rreziku vlerësohet të jetë më i lartë.
- Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të rritur aftësinë për kolposkopi, biopsi dhe trajtimin e simptomave parakanceroze, jo vetëm në Tiranë, por edhe në spitalet e tjera rajonale.
- Sistemi aktual i informacionit bazohet në etiketat e mostrave të mbushjes me dorë dhe manual për personelin. Menaxhimi i dhjetëra mijëra dosjeve individuale do të jetë, së shpejti, një sfidë për ISHP-në. Në të njëjtën kohë, kërkohet mbështetje më e mirë e IT-së së nevojshme për lidhjen elektronike midis regjistrit të kancerit dhe regjistrit të depistimit.
- Udhëzimet dhe protokollet për kontrollin e kancerit të qafës së mitrës në kujdesin shëndetësor parësor do të duhet të rishikohen për t'u pajtuar me praktikën dhe sfidat e reja të programit të depistimit. Gjithashtu, duhet që protokollet të pasqyrojnë parimet e strategjisë së re (ende në proces) të OBSH-së për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.
- Rekomandimet iu dërguan MShMS-së përmes postës elektronike dhe përmes një takimi me drejtorin e përgjithshëm të Politikave Shëndetësore dhe të Kujdesit Social nga UNFPA dhe QShPZh-ja. QShPZh-ja po planifikon të vazhdojë ta çojë përpara këtë punë duke rritur ndërgjegjësimin midis grave elitare, duke monitoruar më tej zbatimin e procedurave standarde operative dhe të mësuarit nga ofruesit e trajnuar të kujdesit shëndetësor, si dhe duke advokuar me MShMS-në për protokollet e kujdesit shëndetësor parësor, për më shumë komplete dhe për përmirësimin e regjistrit të kancerit të qafës së mitrës.



# Projekti: YSAFE për rritjen e kapaciteteve të advokimit - IPPF EN

## Arritjet e projektit

- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Bashkisë së Tiranës për vazhdimin e mëtejshëm të edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) dhe çështjeve të tjera të shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR) në shërbimet që ofrohen nga Bashkia e Tiranës.
- Angazhimi i Bashkisë së Tiranës për të siguruar punën e ESGj-së me fokus të rinjtë që nuk shkojnë në shkollë dhe qendrat sociale për ta avancuar këtë punë në të ardhmen me të rinj të tjerë në ambiente informale.
- Nënshkrimi i një plani advokimi të përbashkët ndërmjet Bashkisë së Tiranës, qendrave sociale, QShPZh-së dhe një OJF-je tjetër partnere.
- Rritja e vetëdijes së drejtuesve të qendrave sociale për rëndësinë e ofrimit të ESGj-së dhe integrimin në shërbimet e tjera të ofruara nga qendrat për të rinjtë me mbështetjen e Bashkisë.
- Fuqizimi i stafit mjekësor dhe punonjësve socialë për të advokuar siç duhet për promovimin e ESGj-së tek të rinjtë që nuk shkojnë në shkollë në qendrat sociale.
- Përmirësimi e zhvillimi i aftësive koordinuese dhe moderuese përmes zbatimit të projektit.
- Hartimi i një plani veprimi advokimi për mundësimin dhe shpërndarjen e ESGj-së jashtë shkollave.
- Bashkëpunimi i 4 drejtorëve të qendrave sociale dhe i Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë e Tiranës me QShPZh-në për hartimin e një plani veprimi advokimi për promovimin e ESGj-së.
- Trajnimi dhe aftësimi i 10 anëtarëve të stafit (5 personel mjekësor dhe 5 punonjës socialë) se si të advokojnë në Bashkinë e Tiranës për sigurimin e ESGj-së dhe ShSR-së në qendrat sociale.
- Zhvillimi i një plani avdokimi nga qendrat sociale që synojnë përfshirjen e të rinjve që nuk shkojnë në shkollë.





**Sfidat e projektit**


- Koordinimi i përgjithshëm i takimeve ishte një sfidë më vete, nëse marrim parasysh agjendën e ngarkuar të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe drejtueseve të qendrave sociale në Bashkinë e Tiranës. Stafi dhe vullnetarët treguan vendosmëri dhe profesionalizëm në koordinimin e punës me drejtorin e përgjithshëm për ta bindur atë që të përfshihet dhe të angazhohet në projekt.
- Vullnetarja përgjegjëse ishte e përgatitur deri në një pikë të caktuar për koordinatorë e një projekti të tërë, edhe pse kishte përvojë të mëparshme me QShPZh-në për të planifikuar dhe zhvilluar aktivitete dhe shërbime në kuadër të projekteve të ndryshme.
- Hartimi i planit të veprimit të advokimit për të qenë gjithëpërfshirës dhe i dobishëm për të gjitha qendrat sociale u bë i mundur pas takimeve dhe trajnimeve me të gjitha qendrat sociale të përfshira në projekt dhe me stafin e tyre.
- Zbatimi me sukses i projektit në një moment kritik emergjence për Shqipërinë, pasi ishte shumë e vështirë të organizohej tryeza e rrumbullakët, do t'u merrte kohë stafeve të qendrave sociale (QS) për t'iu kushtuar planit të veprimit në një kohë paralele për të pritur njerëz të prekur nga tërmeti. Edhe kjo sfidë u adresua si duhet falë vendosmërisë dhe këmbënguljes së stafit në komunikimin me përfaqësuesit e qendrave sociale.

## Projekti: Fol me zë të lartë:

**Veprime të përbashkëta për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës seksuale dhe me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në rrezik të zonave rurale duke përfshirë ato rome dhe egjiptiane**

### **Arritjet e projektit**

- Marrje informacioni dhe aftësish nga 50 punonjës të shëndetit (25 në Vlorë dhe 25 në Tiranë) të qendrave shëndetësore në qytet dhe fshat lidhur me procedurat standarde të punës për viktimat/të mbijetuarat nga dhuna me bazë gjinore, për t'i përdorur këto procedura të hartuara nga shoqata jonë me mbështetjen e UNFPA-s.
- Trajnimi i 80 aktivistëve, të rinj anëtarë të grupit COMBAT, për të realizuar aktivitete ndërgjegjëse me rastin e ditëve ndërkombëtare kundër dhunës.
- Rritja e njohurive të 30 studentëve të mjekësisë për dhunën me bazë gjinore, si shkelje e të drejtave të njeriut dhe efekteve që ka në shëndetin e gruas, si dhe për rrugët efektive në rastet e dhunës në familje.
- Aftësimi i 20 punonjësve të policisë lidhur me çështje të dhunës me bazë gjinore si dhe përdorimin efektiv të mekanizmit të referimit.
- Ndjekja e shfaqjeve teatrale kundër bullizmit nga 5000 persona, me rastin e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në komunitetet rurale të Vlorës dhe të Tiranës si dhe në mediat sociale.
- Shtimi i rasteve të raportuara të dhunës dhe i shërbimeve të ofruara nga klinikat e QShPZH-së, duke shkuar në rreth 437 shërbime të shëndetit riprodhues dhe këshillime psikosociale për çështje të dhunës në familje gjatë vitit 2019.
- Rritja e përgjegjësisë së sistemit të referimit të rasteve të dhunës duke iu përgjigjur në kohë viktimave të dhunës në familje.



- Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që lidhen me dhunën me bazë gjinore.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për të mbështetur viktimat/të mbijetuarat e dhunës.
- Ndërgjegjësimi i 60 drejtuesve të komunitetit dhe anëtarëve të tjerë të tij për parandalimin e DhBGj-së dhe për përmirësimin e qëndrimeve të tyre ndaj dhunës në familje.
- Prodhimi i një spoti publicitar nga rrjeti i organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Vlorës (anëtare të mekanizmit të referimit të DhBGj-së) ku drejtues të komuniteteve, përfshirë edhe ata fetarë, japin mesazhe kundër dhunës me rastin e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit. Spoti u shfaq në ekranin e madh në Skelë dhe pati jehonë në mediat sociale.
- Rritja e përgjegjshmërisë së sistemit të referimit në Vlorë e Tiranë për t'iu përgjigjur çështjeve të DhBGj-së.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të integruara në nivelin e qendrave shëndetësore të lidhura me DhBGj-në.



### Sfidat e projektit

- Mentaliteti patriarkal është ende mbizotërues dhe, siç reflektohet në studimet e fundit, 52.9% e grave dhe vajzave në Shqipëri kanë përjetuar një formë dhune gjatë jetës së tyre. Për ta adresuar këtë çështje, ne kemi përdorur teknikën e teatrit si një mjet inovativ që rrit ndërgjegjësimin kundër DhBGj-së dhe bullizmit në shkolla, kemi punuar për të rritur efikasitetin e mekanizmit të referimit kundër dhunës në Tiranë e Vlorë dhe kemi advokuar për ngritjen e mekanizmit të referimit në bashkitë Himarë dhe Selenicë.
- Studentët e mjekësisë kishin informacion të kufizuar ose të pasaktë për çështje që lidhen me DhBGj-në, me lidhjen e saj me shëndetin publik, me legjislacionin kombëtar për dhunën dhe pasojat e dhunës në shëndetin e gruas, në shëndetin mendor etj. Ata

nuk njihnin asnjë konventë/marrëveshje të ratifikuar nga shteti shqiptar për çështje të dhunës. Gjatë workshop-it, ata fituan njohuri edhe për çështje, të tilla si: detyrat e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje, detyrat e MShMS-së dhe Ministrisë së Brendshme për zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje, sistemi i referimit, plotësimi i urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat etj.

- Pjesa më e madhe e stafit mjekësor që mori pjesë në trajnime, nuk ishte trajnuar asnjëherë për çështje të DhBGj-së. Ata nuk dinin si t'i klasifikojnë format e dhunës dhe nuk njihnin konventat e ratifikuara nga vendi ynë, si dhe kishin informacion të kufizuar për pasojat e dhunës në shëndetin e gruas shtatzënë e në shëndetin mendor, për format e dhunës ndaj fëmijëve dhe për çfarë duhet të bëjnë për t'i ardhur në ndihmë një viktime të dhunës etj.
- Trajnimi i stafit mjekësor ishte një mjet efikas për ta pajisur atë me njohuritë e duhura si pjesë e mekanizmit të referimit të dhunës për t'u ardhur më mirë në ndihmë viktimave/ të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore.



# Projekti: Ofrimi – mundësimi i edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGj) - Të rinjtë në Shqipëri janë të fuqizuar të realizojnë shëndetin, mirëqenien dhe dinjitetin e tyre - IPPF

## Arritjet kryesore

- Nisma e vitit 2019 - një mundësi e rëndësishme për të zgjeruar programin ekzistues të ESGj-së përmes sjelljes së tij te fëmijët dhe të rinjtë në të tri zonat e reja dhe shtrirjen e programit në qendrat e kujdesit rezidencial.
- Ofrimi në vazhdimësi i mbështetjes së ESGj-së në Shqipëri nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe shprehja e dëshirës prej saj për t'u angazhuar në mundësimin e fondeve për OJF-të që punojnë me grupet në nevojë, edhe pse për to mungesa e buxhetit mbetet ende një pengesë shumë serioze.
- Trajnimi i 125 mësuesve nga shkollat e zonave rurale të përcaktuara në projekt për rritjen e njohurive dhe aftësive për të ofruar një program cilësor të ESGj-së për mësuesit e tjerë. Mësuesit e trajnuar i kanë ndarë informacionet, njohuritë dhe aftësitë e fituara me 220 mësuesit e tjerë të shkollave të tyre.
- Trajnimi i 20 profesionistëve të qendrave rezidenciale të kujdesit (psikologë, punonjës socialë; këshillues, menaxherë etj.) për manualin “Sistemi flamur”, me qëllim që të jenë të aftë ta ndajnë këtë sistem në institucionet e tyre, të mbështesin sjelljet e shëndetshme seksuale dhe të frenojnë sjelljet seksuale të papranueshme te fëmijët dhe të rinjtë.
- Ndjekja e sesioneve njëditore nga 100 të rinj nga qendrat e kujdesit për të rinjtë e tri qyteteve (Tiranë, Vlorë, Shkodër), të mbajtura nga profesionistët e trajnuar më parë, dhe ndërgjegjësimi se si të adresojnë sjelljet e papranueshme seksuale.
- Trajnimi i 120 nxënësve si edukatorë bashkëmoshatarë dhe pajisja e tyre me aftësi dhe njohuri për ESGj-në, për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat, për të shmangur abuzimin





seksual e dhunën dhe për të ndërtuar marrëdhënie të respektueshme me të tjerët. Të rinjtë e trajnuar kanë mbajtur sesione informuese për ESGj-në me 720 bashkëmoshatarë.

- Trajnimi për ESGj-në i 20 të rinjve nga qendrat e kujdesit social, grupet e marginalizuara dhe popullata kyç dhe pajisja e tyre me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përdorimin e prezervativit dhe praktikën e seksit të sigurt për të mbrojtur shëndetin nga IST, HIV dhe shtatzënitë e padëshirueshme; për të marrë vendime të informuara, për të komunikuar dhe negociuar në mënyrë efektive dhe për të demonstruar bindje, në mënyrë që të ndërtojnë respekt dhe marrëdhënie më të shëndetshme me anëtarët e familjes, bashkëmoshatarët, miqtë dhe partnerët intimë ose seksualë. 20 të rinjtë kanë ofruar sesione edukimi në qendrat e kujdesit social me 300 të rinj të tjerë.
- Vizita e blogut nga 2000 të rinj, ku ata janë informuar e ndërgjegjësuar për komponentët e ESGj-së dhe efektet e saj pozitive në jetën e të rinjve, shëndetin, mirëqenien, për rëndësinë e ESGj-së dhe adresimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre.
- Informimi i 90 pjesëmarrësve nga komuniteti, përfshirë prindërit dhe liderët e mendimit, për edukimin seksual gjithëpërfshirës të të rinjve dhe për arsyet pse komunitetet duhet të mbështesin informimin dhe edukimin për shëndetin seksual dhe riprodhues tek të rinjtë, përmes një tryeze diskutimi të organizuar nga stafi i QShPZh-së. Ata e kanë ndarë informacionin e marrë për ESGj-në gjatë takimit me 400 anëtarë të tjerë të komunitetit.
- Tryeza e organizuar nga QShPZh-ja me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ministrive (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) palë kryesore, ofrues të shërbimeve shëndetësore, përfitues të projektit dhe organizata ndërkombëtare (WHO, UNICEF, EU, Save the Children etj.), ku u diskutua rreth qasjeve më efektive për të promovuar dhe mbështetur edukimin seksual.
- Ndjekja e shfaqjes teatrale nga 150 persona, organizuar nga të rinjtë vullnetarë të QShPZh-së, dhe kontakti i 1000 personave të tjerë përmes medias sociale me mesazhe pozitive për ESGj-në.



## Sfidat e projektit

- Gjatë takimit me përfaqësuesit e qendrave të kujdesit rinor për t'u prezantuar qëllimin e manualit "Sistemi i flamurit", që do të zhvillohej me profesionistë që punojnë me fëmijë dhe të rinj, në fillim pati një lloj rezistence, sepse ata u shprehën se e kanë një kod sjelljeje që i udhëzon në punën e tyre dhe se, pavarësisht kësaj, ata kurrë nuk janë përballur me ndonjë rast apo situatë të rrezikshme në të gjithë përvojën e tyre të punës për ta konsideruar këtë trajnim si të domosdoshëm. Stafi i QShPZh-së sqaroi qartë se sistemi i flamurit mund t'i ndihmojë ata të kenë standarde për të adresuar sjelljet seksuale të papranuara dhe të kujdesen për shëndetin e fëmijëve në këto institucione.
- Për shkak të kushteve të këqija të motit, teatri nuk u realizua si një shfaqje teatrale në rrugë, por tek "Tulla Center", e cila është një qendër shumë miqësore dhe shumë e frekuentuar nga të rinjtë. Stafi u këshillua me vullnetarët dhe, së bashku, u vendos që aktiviteti të zhvillohej aty. Konceptet e gabuara të mësuesve, për shkak të mungesës së informacionit, përfshijnë zakonisht shqetësimet se edukimi seksual gjithëpërfshirës është i papërshtatshëm për fëmijët e vegjël dhe shkon kundër vlerave kulturore apo fetare lokale, inkurajon fillimin e hershëm seksual ose shkakton 'konfuzion gjinor' dhe mund të përdoret për rekrutimin e të rinjve në 'mënyrat e jetesës alternative' ose për orientimin seksual jo në përputhje me identitetin gjinor. QShPZh-ja dhe vullnetarët theksuan përfitimet shëndetësore, emocionale dhe socio-ekonomike të ESGj-së për fëmijët dhe të rinjtë, familjet dhe tërë shoqërinë.



# Projekti: Le të sfidojmë stigmën ndaj abortit dhe të ndërmarrim veprime – IPPF

## Arritjet kryesore

- Pjesëmarrja e 40 grave nga zonat rurale të Tiranës dhe të Vlorës në seminarin edukues të organizuar nga QShPZh-ja ku u informuan rreth të drejtave të grave për të vendosur mbi trupin e tyre, për të qenë të lira nga riprodhimi i detyruar dhe për të vendosur vetë nëse duan të vazhdojnë shtatzëninë. Grave iu ofrua informacioni bazë rreth abortit dhe çështjeve të tjera, përfshirë edhe mesazhet pozitive rreth abortit, të cilat i ndanë pas përfundimit të seminarit me 100 gra të afërme të tyre.
- Shpërndarja e një videoje për procedurat mjekësore të abortit në median sociale dhe në aktivitetet në kuadër të projektit. Videoja paraqet një përshkrim teknik rreth procedurave, duke i ndihmuar gratë të kuptojnë se sa e rëndësishme është për shëndetin e tyre të kenë alternativa të kujdesit riprodhues. Kjo video është ndjekur nga 500 persona në media sociale ([https://www.youtube.com/watch?v=7shuc\\_FUFRO](https://www.youtube.com/watch?v=7shuc_FUFRO)).
- Trajnimi i 30 ofruesve të shërbimit të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor në zonat rurale të Tiranës dhe të Vlorës për ofrimin e shërbimeve të abortit pa stigma. Pas trajnimit, pjesëmarrësit raportuan se kanë filluar të ofrojnë këshillime miqësore, të paparagjykuara dhe referuese për klientët e tyre.





- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët në Tiranë me 20 vendimmarrës nga MShMS-ja, UNFPA, Operatori i Kujdesit Shëndetësor dhe Fondi i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, ofrues shërbimi lokal dhe grupet e interesit. Në këtë tryezë, përfaqësuesit e OShC-ve u kërkuan politikëbërësve që ata të angazhohen për ta shtruar këtë agjendë dhe të mundësojnë kujdesin riprodhues për gratë duke marrë masa për regjistrimin e mifepristonit.<sup>1</sup>



- Ofrimi nga stafi ynë klinik këshillim për abortin, PAP-teste dhe shërbime të tjera sipas nevojave 150 grave në katër klinika të lëvizshme të QShPZh-së, në bashkëpunim me qendrat shëndetësore lokale në Tiranë dhe Vlorë.

### ***Sfidat e projektit***

- Aktivitetet për ngritjen e aftësive për ofruesit e shërbimeve dhe njohuri të përmirësuara në lidhje me metodat e abortit, pa stigma e këshillime jogjyquese, dhe dispozitat e ligjit mbeten ende një sfidë.
- Gjithashtu, është e nevojshme të zhvillohen më shumë aktivitete informuese dhe edukuese me anëtarët e komunitetit të zonave rurale, sepse ka ende mungesë informacioni dhe akses në shërbime, si dhe të advokohet edhe më shumë me qeverinë për përmirësimin e infrastrukturës dhe për një sistem efektiv të referimit.

<sup>1</sup>steroide që pengon veprimin e progesteronit, që jepet gojarisht në shtatzëninë e hershme për të nxitur abortin.

# Projekti: Përshkallëzimi i përgjigjes ndaj HIV në Shqipëri - IPPF

## Arritjet kryesore

- Vazhdimi i përpjekjeve të QShPZh-së edhe gjatë vitit 2019, përmes zbatimit të këtij projekti, për të përmbushur nevojat e të rinjve nga popullata kyç (personat që injektojnë drogë, MSM dhe punonjëset e seksit) duke ofruar informacione dhe shërbime pastigma që t'iu fuqizojë ata të veprojnë në bazë të të drejtave të tyre. 2218 shërbime të HIV u janë ofruar individëve 0-99 vjeç përmes klinikave të QShPZh-së dhe shërbimeve të ofruara në komunitet.
- Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të 40 ofruesve të shërbimit parësor të qendrave të kujdesit shëndetësor nga Tirana dhe Vlora për të ofruar shërbime pa stigma dhe paragjykim për popullatën kyç. Pjesëmarrësit në këtë trajnim mësuan pse është e rëndësishme të luftojmë stigmën ndaj HIV dhe si të adresojnë suksesshëm shkaqet dhe pasojat e saj tek institucionet shëndetësore.
- Raportimi nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, në takimet vijuese dhe në komunikimin e rregullt me stafin e QShPZh-së, për përmirësimin e shërbimeve të ofruara dhe një numër të shtuar të shërbimeve që marrin klientët me 20%.
- Koordinimi me Fakultetin e Shkencave Sociale dhe atë të Infermierisë, me të cilin QShPZh-ja ka një partneritet efektiv, për t'u ofruar 300 teste të shpejta dhe këshillime para dhe pas testit.
- Organizimi i një seminari dyditor në Tiranë me pjesëmarrjen e 20 gazetarëve tradicionalë dhe të medias sociale. Pjesëmarrësit u pajisën me informacion, njohuri e aftësi dhe me vlerat e nevojshme për të informuar publikun në mënyrë të paanshme në lidhje me rastet me HIV dhe për të përçuar mesazhe pozitive në lidhje me grupet kryesore të popullsisë, përfshirë ata që jetojnë me HIV, IDU, MSM dhe romët.
- Pasqyrimi në 20 produkte mediatike i mësimeve të trajnimit, që u përgatitën nga gazetarët e trajnuar dhe u shpërndanë përmes kanaleve të ndryshme (media sociale dhe tradicionale).





Stafi i QShPZh-së dhe aktivistët përshtatën mesazhe pozitive në lidhje me informimin për HIV dhe ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për mënyrën e parandalimit të transmetimit të HIV, ku mund të marrin shërbime etj.

- Vazhdimi i përdorimit nga QShPZh-ja i platformave të mediave sociale, edhe gjatë këtij viti, për të informuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin për HIV me synim krijimin e qëndrimeve pozitive dhe një mjedisi mbështetës ndaj popullatës kyç. Mesazhe pozitive të përshtatura u përgatitën me përfshirjen e aktivistëve të grupeve të cënueshme të QShPZh-së.
- Dhënia për publikun e gjerë të informacioneve të tjera të dobishme, si: ku mund të merrni shërbime; si të parandaloni transmetimin e HIV etj. 2000 persona morën mesazhe pozitive përmes kanaleve online dhe offline.



## Sfidat e projektit

- Mbështetja e popullatës kyç me shërbime të kujdesit shëndetësor mbetet ende një sfidë, sepse njerëzit nuk preferojnë të vizitojnë institucione të kujdesit shëndetësor, për shkak të diskriminimit me të cilin përballen nga ofruesit e kujdesit shëndetësor anëtarët e komunitetit etj. Kështu që sjellja e tyre në klinikat e QShPZh-së kërkon gjithmonë përgatitje dhe koordinim të mirë.
- Ofrimi i testimit të HIV në klinikat e QShPZh-së u mundësua nga bashkëpunimi me organizatat, të cilat punojnë drejtpërdrejt me popullatat kyç. Stafi i organizatave partnere i përgatiti ato paraprakisht në lidhje me shërbimet tona, të cilat garantojnë konfidencialitet, siguri e cilësi dhe janë të bazuara në të drejta ndaj gjinisë.
- Ekziston një njohje e kufizuar e lidhjes së rëndësishme midis stigmës ndaj HIV dhe rezultateve të shëndetit publik, të tilla si: cilësia e kujdesit të klientit dhe kapaciteti i fuqisë punëtore; stigma dhe diskriminimi nga punonjësit e shëndetit komprometojnë sigurimin e tyre të kujdesit cilësor, i cili është thelbësor për të ndihmuar klientët të ruajnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre të përgjithshme; stigma vepron si një pengesë për qasjen në shërbime për popullatën e përgjithshme, veçanërisht për popullatën kyç.

# Projekti: Mbrojtja e së drejtës për një jetë të lirë nga detyrimi seksual, kërcënimi dhe dhuna - IPPF

## Arritjet e projektit

- Zhvillimi i katër fokus-grupeve të veçanta me të rinjtë në shkollë, ofruesit e kujdesit shëndetësor, anëtarët e grupit parlamentar për popullsinë dhe zhvillimin dhe gratë e vajzat.
- Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi në Fier, në 2 maj, në sheshin kryesor të qytetit, duke mbledhur përfaqësues nga institucionet vendore, si: Bashkia, Drejtoria e Shëndetit Publik, vullnetarë të rinj nga qendra “Epoka e Re” etj. Mbi 50 kalimtarë - përfshirë të rinjtë, gratë dhe anëtarët e komunitetit - u njohën me mesazhet e riformatuara.
- Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi në qytetin e Elbasanit, në 3 maj, me pjesëmarrjen e rreth 100 personave, përfshirë studentë të Fakultetit të Infermierisë, përfaqësues nga organizatat lokale, Drejtoria Rajonale e Shëndetit, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe anëtarët e komunitetit (15 romë e egjiptianë dhe 15 anëtarë nga zonat rurale).
- Organizimi i një seminari nga QShPZh-ja me pjesëmarrjen e 20 gazetarëve, me qëllim prezantimin në mënyrë të detajuar të gjuhës së re dhe krijimin e një partneriteti më të ngushtë me median dhe ekspertë të komunikimit. Përvoja e seminarit u nda në mediat sociale duke u ndjekur nga një total prej 1500 personash, së bashku me botimin e një artikulli në dy media online “Alert News”.



- Hartimi i një pyetësoi online me mesazhe të riformatuara nga një ekspert, në nëntor, me mbështetjen e stafit të QShPZh-së, në lidhje me edukimin seksual gjithëpërfshirës, kontracepsionin dhe të drejtat e grave, me qëllim testimin e opinioneve, ndjenjave, dhe të kuptuarit në një audiencë më të madhe. Pyetësoi në internet u zgjodh si një mjet efektiv për të provuar këto mesazhe bazuar në kohën që njerëzit kalojnë në internet, si dhe për të arritur një audiencë më të madhe dhe të përzier në krahasim me metodat tradicionale.



- Krijimi i një blogu nga QShPZh-ja, me ndihmën e një eksperti, si një pjesë e integruar e faqes së internetit, si një mjet interaktiv, inovativ dhe afatgjatë për të shkëmbyer mesazhe përmes historive dhe për të marrë reagime nga emocionet dhe përgjigjet e njerëzve nga këto histori. Në ditët e sotme, blogu është kthyer në një mjet të dobishëm për të shkëmbyer dhe tërhequr vëmendjen e njerëzve të tjerë.

## Sfidat e projektit

- Në përgjithësi, mesazhet tona u pritën mirë, megjithatë pati disa kundërshtime lidhur me termat specifike. QShPZh-ja nuk duhet të përdorë modelet e kundërshtarëve dhe as t'i injorojë ato, përkundrazi, duhet të prodhojë e të përdorë vazhdimisht modele të reja, në mënyrë saktë dhe të qartë.
- Riformatimi i mesazheve në lidhje me temat e të drejtave të grave, kontracepsionin dhe edukimin seksual gjithëpërfshirës ishte një sfidë, pasi ato duhej të ishin sa më afër kontekstit shqiptar dhe të pranoheshin sa më shumë që të ishte e mundur, për të pasur sukses në përdorimin e vazhdueshëm nga grupet e synuara.
- Përdorimi i gjuhës së rafinuar sa më shumë që të jetë e mundur në postimet në media sociale, mbetet ende një sfidë, për të cilën QShPZh-ja duhet të vazhdojë të bëjë përpjekje të shumta. Mediat sociale janë kanale shumë të fuqishme të komunikimit, ndaj organizata duhet të forcojë punën e saj për të përcjellë mesazhe të riformatuara të shëndetit riprodhues dhe të arrijë një audiencë më të madhe të synuar.
- Puna e rregullt me median, gazetarët dhe ekspertët e komunikimit mbetet një nga aspektet e veprimtarisë sonë për të siguruar që mesazhet e dërguara prej tyre të jenë në



përputhje me misionin dhe vlerat morale të QShPZh-së dhe IPPF-së.

- Mesazhet e përdorura në pyetësin në internet morën komente pozitive, por u dhanë dhe sugjerime në lidhje me termat specifike. Shumë të anketuar shprehen se audienca nga zonat rurale ose nga komuniteti i marginalizuar ka nevojë për shpjegime të mëtejshme për këta terma, gjë që kërkon më shumë përpjekje nga QShPZh-ja në të ardhmen për punën me këto grupe të synuara.



# Projekti: YATAS- Aktivizmi rinor për të luftuar stigmën ndaj abortit - IPPF

## Arritjet e projektit

- Përfshirja e 2609 të rinjve në aktivitete të ndryshme, siç janë: trajnimet, seancat informuese, pjesëmarrja në panairin rinor, eksperimenti social, shfaqja në radio, ndërgjegjësimi publik (28 shtator), materialet e IEK-së dhe postimet në Facebook.
- Përfshirja e 42 të rinjve (27 nga Fakulteti i Mjekësisë) në trajnimin e edukimit bashkëmoshatar. 80% e tyre tani janë anëtarë të QShPZh-së, ndërsa 35% e tyre pjesëmarrës aktivë të projekteve dhe aktiviteteve të organizatës sonë.
- Përfshirja e 250 personave në eksperimentin social si pjesëmarrës në panair dhe njohja prej tyre me materialet e IEK-së që u shpërndanë.
- 1800 të rinj, nga 2609 të përfshirë në aktivitete, janë vajza. 340 janë nga pakica rome dhe rreth 200 prej tyre janë vajza të moshës 14-29 vjeç. 35% e të rinjve janë nga zonat ndërrbane dhe rurale të Tiranës.
- Shpërndarje tek të rinjtë e 500 materialeve të IEK-së. Të rinjtë e përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete (42 edukatorë bashkëmoshatarë të trajnuar dhe 10 edukatorë bashkëmoshatarë të QShPZh-së të angazhuar në projekt) fituan njohuri për çështjet që lidhen me abortin dhe ndryshuan konceptin për abortin. Konkretisht, rezultatet e testit para dhe pas seancave të trajnimit treguan një ndryshim në njohuri për temën e abortit në përgjithësi (niveli i informacionit të fituar u rrit nga 50% në 80%).
- Paraqitja në Radio Show e nismës nga të rinjtë, si dhe ndarja prej tyre e informacioneve dhe përvojës së fituar gjatë projektit. Këto ishin rezultat i rritjes së njohurive dhe kuptueshmërisë së qartë të temës për abortin pa stigma nga të rinjtë. Mesazhet pozitive që transmetuan, si “Ndërprerja e shtatzënisë është e drejtë njerëzore”, “Çdo grua dhe vajzë ka qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore të abortit pa stigma dhe diskriminim”, treguan se ata i bënë të tyret vlerat e të drejtave të njeriut në lidhje me abortin.
- Këshillime 50 të rinjve për abortin, si rezultat i projektit (sipas intervistave të dhëna



nga klienti). Gjatë aktiviteteve u dhanë shembuj se si ata mund të aksesojnë shërbimet shëndetësore në klinikat e licencuara nga autoritetet, përveç klinikave të QShPZh-së. Nga reagimet e mbledhura ishte e dukshme rritja e njohurive të të rinjve. Ajo që duhet të theksohet është kërkesa e tyre për informacion të mëtejshëm për procedurën e administrimit të abortit të sigurt (për ta diferencuar atë nga procedura e pasigurt), si dhe për mënyrën si ta përdorin ligjin si një mjet për të reduktuar stigmën dhe për të parandaluar rastet e paligjshme të abortit etj.

- Panairi rinor i organizuar nga Bashkia Tiranë, i cili u shfrytëzua nga të rinjtë për të shpërndarë fletëpalosje të përgatitura në emër të projektit dhe, në të njëjtën kohë, për të kryer eksperimentin social. Një numër i madh i të rinjve u përfshinë në aktivitete inovatore, siç është eksperimenti social, veçanërisht për çështje të ndjeshme si aborti.
- Krijimi nga QShPZh-ja i grupit bërthamë të të rinjve (Grupi Rinor YATAS), të pajisur me aftësi, informacion dhe vlera për abortin, për t'ua shpërndarë të rinjve të tjerë në komunitetin e tyre. Grupi bërthamë, që u krijua në fillim të projektit me 10 të rinj, pas projektit u zgjerua me 16 të rinj të tjerë, veçanërisht me të rinj që morën pjesë në seanca trajnimi. Për rrjedhojë, QShPZh-ja ka, tashmë, një grup të kualifikuar kushtuar çështjeve të abortit, të përbërë nga 26 të rinj.
- Angazhimi në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit i 42 të rinjve të trajnuar si edukatorë bashkëmoshatarë, të motivuar jo vetëm për të marrë pjesë në këtë projekt, por dhe në projekte të ndryshme të QShPZh-së (Aftësi jetësore, fuqizim, duke ofruar shërbime ShR falas). Kjo qasje do të mundësojë vazhdimin e objektivave të projektit YATAS edhe pas përfundimit të tij.



## Sfidat e projektit

Në përgjithësi, projekti i ideuar nga të rinjtë, anëtarë të qendrës rinore të organizatës sonë, i përmbushi objektivat e tij. Sidoqoftë, disa sfida u hasën gjatë fazës së zbatimit:

- Projekti ishte i kufizuar në kohë dhe financim, ndërkohë që materiale të ndryshme të IEK-së ishin të nevojshme për të tërhequr më shumë të rinj përmes tij. Materialet pamore janë mjet i mirë për t'i tërhequr dhe angazhuar të rinjtë në një temë kaq të ndjeshme siç është

aborti. Për këtë arsye, QShPZh-ja mendon se materiale më të larmishme (çanta, byzylykë, gota etj.), si dhe fletëpalosje, do të kishin mundësuar përfshirjen e më shumë të rinjve.

- Më shumë informacion dhe aftësi praktike duhet të sigurohen për të rinjtë për të luftuar diskriminimin dhe stigmën ndaj abortit. Projektet afatgjata, të hartuara nga vetë të rinjtë, janë të nevojshme për të eliminuar diskriminimin, stigmën dhe paragjykimet në lidhje me çështjet e abortit.



# Projekti: Advokim dhe partneritetet për të drejtat riprodhuese dhe reduktim i pabarazive të të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues - UNFPA

## Arritjet e projektit

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin është e fokusuar në advokim dhe partneritet me OJF të tjera, institucione dhe udhëheqës të komunitetit për të mundësuar të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues në Shqipëri. Në partneritet me UNFPA Albania, bazuar në planin e përbashkët vjetor të punës, QShPZh-ja punoi për përmirësimin e kuadrit ligjor për shëndetin seksual dhe riprodhues. Ajo krijoi një grup ekspertësh me përvojë të gjatë me ligjet në Shqipëri dhe me njohuri e aftësi të veçanta për të drejtat seksuale dhe riprodhuese. Analiza e kornizës ligjore të deritanishme për shëndetin riprodhues dhe të drejtat në Shqipëri, “status quo” nga perspektiva e aksesit në shëndetin seksual e riprodhues dhe të drejtat pas Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD), Deklaratës së Beijing dhe Platformës për Veprim dhe standardeve të tjera ndërkombëtare u përgatit nga QShPZh-ja dhe grupi i saj i ekspertëve. Në këtë proces u përfshinë grupe të ndryshme të interesit. U krye një takim me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu, si dhe një takim me drejtoreshën e përgjithshme të kësaj ministrie dhe me UNFPA. Takimi rezultoi në krijimin dhe organizimin e një grupi ekspertësh nga MShMS-ja, përgjegjës për rishikimin e ligjit për shëndetin riprodhues. Ky grup do të bashkëpunojë ngushtë me grupin e ekspertëve të QShPZh-së. Tri takime për gjenerimin e ideve u zhvilluan nga grupi i ekspertëve të QShPZh-së në Shkodër, Vlorë dhe Tiranë me pjesëmarrjen e OJF-ve lokale dhe të ekspertëve në fushën e shëndetit riprodhues në Shqipëri. Një memorandum u përgatit dhe u dorëzua në MShMS.

- Në vitin 2018, UNFPA Albania, në partneritet me QShPZh-në, themeloi një grup tjetër ekspertësh, i përgatiti Planin Kombëtar për të moshuarit në Shqipëri, që u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 24.12.2019, “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020-2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij” (<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/864/277fafa6-f845-4b1b-9d18-0dc7de9a55bb> - Publikimi në Fletoren Zyrtare, Nr. 183, hyri në fuqi më 30.12.2019).
- UNFPA dhe QShPZh-ja vazhdojnë të mbështesin Shoqatën Shqiptare të Demografëve për të botuar dy numra të përvitshëm të revistës demografike për popullsinë dhe zhvillimin, për kërkim, publikim dhe shpërndarjen revistës “Demografia”. Në total janë botuar 2 numra, ku janë publikuar artikujt e më shumë se 14 autorëve të ndryshëm, dhe janë shtypur e shpërndarë 320 kopje.



## Studimi për vlerësimin e madhësisë së popullatës kyç në Shqipëri

Për të përmirësuar efikasitetin e reagimit të Shqipërisë ndaj epidemisë së HIV dhe planifikimin e programeve të parandalimit e trajtimit, është e rëndësishme të merren të dhëna për madhësinë kryesore të popullatave kyç. Grupe, të tilla si njerëzit që injektojnë droga (PWID), punonjësit e seksit (SW) dhe meshkuj që kryejnë seks me meshkuj (MSM), i përkasin popullatës së fshehur. Prandaj statistikave zyrtare nuk mund të japin shifra reale për numrin e tyre. Një studim i posaçëm u krye për vlerësimin e madhësisë së popullsisë. Ky projekt studimor paraqet metodat dhe rezultatet e vlerësimit të madhësisë së popullsisë për secilin prej vlerësimeve të qarkut/rajonit dhe në nivel kombëtar.



Studimi Bio-BSS përfundoi në nëntor 2019 dhe të dhënat e tij u përdorën nga studimi “Vlerësimi i madhësisë së popullatave kyç” për të arritur objektivat e tij dhe për të llogaritur tregues të ndryshëm të vendosur gjatë skicimit të studimit.

- U përgatit një raport i përgjithshëm dhe u nda me grupet e interesit.
- U zhvillua një tryezë e rrumbullakët dhe gjetjet kryesore u ndanë me pjesëmarrësit.

Përmbledhja e vlerësimeve rajonale dhe kombëtare midis PWID, MSM dhe SW:

- Njerëzit që injektojnë drogë (PWID) – Shqipëri: 6970 persona.
- Punonjësit e seksit (SW) – Shqipëri: 2200 persona.
- Meshkuj që bëjnë seks me meshkuj (MSM) – Shqipëri: 7060 persona.

QShPZh-ja ka krijuar një partneritet të ngushtë me Parlamentin e Shqipërisë. Janë zhvilluar takime ndërgjegjësuere me gratë deputete dhe me komisione e nënkomisione të ndryshme parlamentare për të promovuar politikën dhe dialogun e advokimit për rritjen e investimeve të vendit në shëndetin seksual dhe riprodhues.

- 4 takime për dialog politik janë realizuar me anëtarët e parlamentit për çështje që lidhen me ICPD-në, ShSR-në dhe dhunën me bazë gjinore.

# Projekti: Qasje e barabartë në shërbimet e integruara të shërbimeve riprodhuese (ShR) me cilësi - UNFPA

## Arritjet e projektit

### I. Përhapja dhe zbatimi i standardeve dhe udhëzuesve për ofrimin e shërbimeve miqësore për të rinjtë (ShMR), përfshirë ofrimin e shërbimeve për të rinjtë nga popullatat kyç në shërbimet shëndetësore parësore

U rishikua udhërrëfyshi “Udhëzime klinike për kontrollin e shëndetit, rritjen dhe zhvillimin e adoleshentit për ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor”, miratuar nga MShMS-ja në vitin 2016, në bazë të kërkesës së UNFPA-s Shqipëri dhe QShPZh-së.

MShMS-ja dhe QShPZh-ja ngritën një grup ekspertësh për të rishikuar dhe përditësuar udhërrëfyesin, pasi ai nuk përshtatej me temën kryesore të kapitujve përkatës. Ky dokument është gati të dorëzohet në MShMS për miratim.

### II. Fuqizimi i kapaciteteve për zhvillimin e udhëzimeve klinike në shëndetin seksual dhe riprodhues

- Në rajonet e Shkodrës dhe të Elbasanit u zhvillua trajnim dyditor pas trajnimeve të vitit të kaluar për të njëjtën temë në rajone të tjera.
- 65 pjesëmarrës morën pjesë në kurs (30 në Shkodër dhe 35 në Elbasan): menaxherë të qendrave shëndetësore, gjinekologë, mami nga qendra e planifikimit familjar të kujdesit shëndetësor parësor.
- Në vitin 2018, QShPZh-ja zhvilloi dy trajnimet e para për zbatimin e udhërrëfyesve klinikë për



shëndetin seksual dhe riprodhues në rajonet e Tiranës dhe të Vlorës. Gjatë vitit 2019, Shkodra dhe Elbasani ishin dy rajone të tjera të mbuluara. Ofruesit e kujdesit shëndetësor nga të gjitha rajonet e Shqipërisë u aftësuan për zbatimin e udhërrëfyeseve klinikë.

### **III. Forcimi i gatishmërisë së mekanizmave kombëtarë të reagimit në ofrimin e shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues gjatë krizave humanitare dhe emergjencave (Projekti MISP)**

- MShMS-ja dhe QShPZh-ja ngritën një grup ekspertësh për të hartuar paketën MISP.
- Manuali i ndër agjencie “Paketat e shëndetit riprodhues për situatat në kohë krize”, i shqyrtuar plotësisht dhe i përditësuar nga njësia e Seksualitetit dhe Planifikimit Familjar të Zyrës Rajonale të OBSH-së për Europën, shërbeu si burimi kryesor ku u fokusua grupi i punës.
- Trajnimi u zhvillua në rajonin e Korçës me pjesëmarrjen e ofruesve të kujdesit shëndetësor nga ky rajon.
- U forcuan dhe u përmirësuan kapacitetet e 22 ofruesve të kujdesit shëndetësor.
- 5 objektivat e MISP-së, legjislacioni dhe dokumentet e tjera që lidhen me emergjencat civile, u ndanë dhe u diskutuan me pjesëmarrësit.
- U shtypën 115 kopje të broshurës “Mëmësi e sigurt”, 100 prej të cilave u shpërndanë në Korçë dhe, më vonë, pas tërmetit të 26 nëntorit, në Tiranë.

### **IV. Zhvillimi i një kursi trajnimi online përmes përdorimit të platformës së planifikimit familjar, ViC**

Ky trajnim përbëhet nga 4 module dhe pati shtrirje kohore nga 1 tetori deri më 31 dhjetor. 48 kandidatë u regjistruan në këtë kurs trajnimi online. Profili i tyre është kryesisht mjek i përgjithshëm dhe infermier. Me gjithë numrin e kandidatëve të regjistruar, vetëm një pjesë e vogël e tyre përfunduan me sukses kursin e trajnimit.

### **V. Kanceri i qafës së mitrës: Zbatimi i Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në kujdesin shëndetësor parësor në Shqipëri**

- Më 30 janar 2019, Këshilli i Ministrave miratoi për herë të parë Programin Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në kujdesin shëndetësor parësor në Shqipëri pas një advokimi të gjatë nga QShPZh-ja dhe partnerët e saj.

- 6.1% ishin pozitivë për HPV me rrezik të lartë (HR-HPV) dhe kjo do të përbënte përhapjen e shkallës së pozitivitetit për këtë kategori të testuar.
- Përhapja e infeksionit HR-HPV është 20% më e lartë në qytet se në fshat.
- 403 profesionistë të shëndetit morën pjesë në aktivitetet trajnuese: 235 infermierë dhe 168 mjekë.
- 10 kurse trajnimi u zhvilluan në 10 qarqe të Shqipërisë.
- 4 bashkëpunime zyrtare u realizuan me Autoritetin Shëndetësor Rajonal.
- Në secilin prej 35 rrethesh shëndetësore tani ekziston një strukturë funksionale me një koordinator përgjegjës për programin që monitoron shpërndarjen e materialeve në qendrat shëndetësore, mbledhjen e mostrave vaginale dhe shpërndarjen e tyre në laboratorin kombëtar pranë ISHP-së.



### ***Sfidat e projektit***

- Qendrat e kujdesit shëndetësor në Shqipëri nuk ofrojnë shërbime miqësore për të rinjtë, pavarësisht se këto shërbime janë miratuar dhe duhet të ofrohen në kujdesin shëndetësor parësor.
- Ofruesit e kujdesit shëndetësor nuk kanë kapacitetin e duhur për të ofruar këtë lloj shërbimi shëndetësor, ndaj është i nevojshëm trajnimi kombëtar.
- Nga ana tjetër, të rinjtë nuk kanë informacion për shërbimet miqësore, si dhe ku sigurohen ato.
- Pavarësisht trajnimeve të MISP-së, të kryera në Shqipëri, dhe urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, situata pas tërmetit tregoi se duhet më shumë punë për sa i përket MISP-së në Shqipëri.



# Projekti: Dhuna me bazë gjinore dhe barazia gjinore, adresuar përmes përgjigjes shumësektoriale - UNFPA

## Arritjet e projektit

### Udhërrëfyesit esencialë dhe procedurat standarde të veprimit (PSO) për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në një qasje shumësektoriale

Pavarësisht se projekti u përball me shumë vonesa, ai mund të konsiderohet shumë i rëndësishëm, për disa arsye:

- Procesi hapi gjerësisht diskutimin për të rregulluar shërbimet e ofruara me procedura standarde të veprimit që unifikojnë ndërhyrjen në të gjitha drejtimet shumësektoriale në nivelin lokal, të paktën për shërbimet shëndetësore dhe të kujdesit shoqëror.
- Procesi angazhoi shumë aktorë për të shkëmbyer mendimet mes njëri-tjetrit dhe për t'u përkushtuar në shërbimet efektive që do të bazohen në udhërrëfyes konkretë dhe do të rriteshin nevojën për të pasur qasje gjinore gjatë përdorimit me viktimën në qendër, një parim që duhet të zbatohet jo vetëm për rastet e dhunës me bazë gjinore, por dhe për ato në familje.
- Procesi bashkoi profesionistë të disiplinave të ndryshme, të cilët siguruan azhurnimet e tyre në paketën origjinale dhe e bënë atë të përshtatshme për t'u zbatuar në Shqipëri. Paralelisht, procesi mbledhi institucione të ndryshme shtetërore të cilat, përkundër mendimit të tyre për miratimin e paketës, u ndërgjegjësuat për rëndësinë e përdorimit të procedurave standarde të veprimit në menaxhimin e rasteve.
- Edhe pse nuk u miratua nga Policia e Shtetit Shqiptar (për pjesën e policisë), me arsyetimin se policia kishte procedurat e veta standarde të veprimit, paketa shërbeu si një udhëzues për procedurat standarde të veprimit shtesë të përgatitura nga Policia e Shtetit posaçërisht për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.
- Procedurat standarde të veprimit, të rishikuara, pasi të miratohen, do të ndikojnë në përmirësimin e efektivitetit dhe të performancës së punonjësve të shëndetësisë dhe atyre socialë për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe rastet e dhunës në familje në Shqipëri. Ndërsa ata me status “në pritje” (për drejtësinë dhe policinë) do të jenë një bazë e mirë për zhvillimin e udhëzimeve shtesë, kur është e nevojshme, në lidhje me menaxhimin e çështjeve nga drejtësia dhe policia.

- QShPZh-ja e zgjeroi punën e saj dhe u bë anëtare e dy mekanizmave referues të koordinimit në Shqipëri, në bashkitë Himarë dhe Selenicë.
- U bë i mundur përditësimi i udhërrëfyeseve për ofruesit e kujdesit shëndetësor, si dhe manuali i trajnimit për aktivitetet e planifikuara për ndërtimin e kapaciteteve me këta profesionistë.
- U koordinua puna me MShMS-në për përmirësimin e përmbajtjes së paketës së procedurave standarde të veprimit për ofruesit e kujdesit shëndetësor, si dhe për përgatitjen e të gjitha materialeve shtesë për ta bërë paketën gati për miratim.
- Në një takim konsultues, u prezantua gjithë paketa e modelit të përgjithshëm të reagimit shumësektorial ndaj dhunës me bazë gjinore.

### **Programi i trajnimit i bazuar në të drejtat e njeriut, fokusuar në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për komunitetin LGBT**

- U hartua manuali “Ofrimi i shërbimeve miqësore HIV/AIDS për komunitetin LGBT- Trajnim udhëzues për ofruesit e kujdesit social dhe shëndetësor për komunitetin LGBT në kujdesin shëndetësor parësor”, bazuar në objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë për vitet 2016-2020.
- 24 ofrues të kujdesit shëndetësor nga një shumëllojshmëri të specialiteteve shëndetësore, si mjekë, infermierë, dentistë dhe staf psiko-social, morën pjesë, për herë të parë, në një kurs trajnimi dyditor.

### **Rritja e përgjegjshmërisë së institucioneve qeveritare përgjegjëse për instrumentet ligjore ndërkombëtare (UPR, CEDAW, GREVIO etj.) - Mbështetja e pjesëmarrjes së delegacionit shtetëror në aktivitetin e UPR-së**

- Delegacioni shqiptar u mbështet për të marrë pjesë në aktivitetin ndërkombëtar të UPR-së.
- U ngrit grupi i punës për rishikimin periodik të përgjithshëm në përputhje me rezolutën 5/1 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, i cili mbajti seancën e 33-të, nga 6 deri në 17 maj 2019. Shqipëria paraqiti raportin e saj kombëtar nën UPR në shkurt 2019.
- QShPZh-ja mbështeti pjesëmarrjen e drejtores së përgjithshme të MShMS-së në takimin e 12-të të grupit të punës për plakjen në rolin e pikës kombëtare të kontaktit në atë grup.

## Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe angazhimin e djemve dhe burrave

- Në vitin 2019, QShPZh-ja u bë pjesë zyrtare e rrjetit “Men Engagement”.
- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Vajzave, u kryen aktivitete ndërgjegjësimi nga UNFPA dhe QShPZh-ja për arsimimin dhe shëndetin e vajzave adoleshente në Selenicë, në Vlorë dhe në Shkodër.
- Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit u dhanë dy shfaqje teatrale në dy ambiente të ndryshme: një shfaqje teatrale në një prej ambienteve ku qëndronin të prekurit nga tërmeti dhe një tjetër në qendrën kulturore “Tulla”.
- Forumi “Djemtë e burrat që frymëzojnë” i pari në Shqipëri në llojin e vet, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit, përdori “qasjen transformuese gjinore”.
- Gjatë fillimit të saj, fushata në emër të 16 Ditëve të Aktivizmit u mbështet nga MShMS-ja.



## Rezultatet e aktiviteteve ndërgjegjëse në lidhje me dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe angazhimin e djemve dhe burrave

- Në total u angazhuan 225 persona, ballë për ballë, nga të cilët 154 gra e vajza dhe 60 burra e djem.
- U anëtarësuan 62 të rinj, si vullnetarë, në Qendrën Rinore “PO”, nga të cilët 27 djem dhe 35 vajza.
- U hartua fletëpalosja “Angazhimi i djemve dhe burrave”.
- U vendosën ura të reja bashkëpunimi dhe u forcuan të mëparshmet midis QShPZh-së dhe grupeve të marginalizuara (pakica rome, personat me HIV/AIDS, komuniteti LGBT, përdoruesit intravenozë të drogës), përfaqësuesit e sektorit privat dhe organizatat lokale.
- Në “Akademia e të Drejtave të Njeriut”, e organizuar nga Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, morën pjesë 13 djem dhe 15 vajza, prej të cilëve 2 anëtarë të komunitetit LGBT, 1 anëtar i pakicës rome dhe 8 të rinj nga zonat rurale. Nga pjesëmarrësit u hartua plani i vazhdimësisë.
- 7 të rinj nga rajone të ndryshme (Berati, Vlora, Fushë-Kruja dhe Tirana) u mbështetën për të marrë pjesë në programin mësimor 8-ditor në Tiranë për STUDIMIN E ARTIT TË PERFORMANCËS, edukimin e bazuar në teatër, aktivitete ndërgjegjësimi për të rinjtë, performancë etj., zbatuar nga DOART. Të rinjtë performuan një shfaqje teatrale gjatë festivalit “REJA”, e përqendruar në çështjet gjinore. Shfaqjen e ndoqën 70 pjesëmarrës.
- U mbështet aktiviteti “Te Reja” - Pjesëmarrja e artistëve të rinj ndërkombëtarë. Këta artistë performuan një shfaqje teatrale të përqendruar në çështjet gjinore dhe LGBT. Performancën e tyre e ndoqën 100 pjesëmarrës.

### Sfidat e projektit

- Mungesa e informacionit dhe e kapaciteteve për procedurat standarde të veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje në një qasje shumësektoriale kërkon rritjen e kapaciteteve për punonjësit e shëndetësisë dhe ofruesit e shërbimeve sociale. Do të nevojiten trajnime të ndryshme për të bërë që procedurat standarde të veprimit të zbatohen lehtësisht.
- Programet e trajnimit të bazuara në të drejtat e njeriut që mbulojnë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për LGBT-në, duhet të rishikohen nga një qasje gjinore.
- Angazhimi i djemve dhe burrave në këto tema është ende i rrethuar nga stigma dhe paragjykime. Vetëm disa prej tyre janë të angazhuar, por nuk promovohen sa duhet në shoqëri.
- Projektet e ndryshme duhet të përqendrohen në angazhimin konkret të djemve dhe burrave, veçanërisht të grupeve më të prekura nga kjo dukuri.
- Media luan një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e rolit të djemve dhe burrave në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe çështjeve të shëndetit riprodhues.



- Duhet rritur mbështetja e aktivistëve lokalë dhe e organizatave lokale dhe aftësitë tyre në zbatimin e projekteve me fokus “Qasjen transformuese gjinore”.
- Duhet promovuar djemtë dhe burrat që janë të përfshirë në tema të tilla, dhe jo vetëm, por që janë model për të tjerët.
- Nevojitet rritja e partneriteteve me sektorin privat dhe me institucione, të tilla si Policia e Shtetit.

# Projekti: Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri - BE

## Arritjet e projektit

- Rritja e forcimi i kapaciteteve dhe i kompetencave për çështje kyç të zhvillimit të organizatave si dhe për çështje të menaxhimit të projekteve për një total prej 30 OShC (Organizata të Shoqërisë Civile) të reja, të krijuara vitet e fundit (14 OShC nga rajoni i jugut dhe 16 nga rajoni i veriut).
- Përmirësimi i mjedisit mundësues për një kontribut më të ndjeshëm të shoqërisë civile në proceset e integritimit në BE, si dhe në procese të tjera të rëndësishme në vend, përmes përpjekjeve të përbashkëta të advokimit dhe rritjes së dialogut me qeverinë.
- Përfshirja e 51 OShC-ve (34 nga Vlora dhe 27 nga Shkodra) në studimin për vlerësimin e nevojave. Studimi zbuloi dhe konfirmoi nevojën që kanë OShC-të për rritje të kapaciteteve, për planifikim strategjik dhe rritje e forcim të rrjeteve e koalicioneve për një ndikim më të mirë e për më shumë arritje advokimi. Procesi i vlerësimit të nevojave shërbeu, gjithashtu, si një mjet për të ndihmuar zyrat e qendrave kombëtare burimore (QKB), të hapura në Vlorë e Shkodër, për të njohur më mirë çdo OShC, arritjet dhe sfidat, si dhe ndihmoi koordinatoret e këtyre zyrave të krijojnë database e tyre të detajuara me nevojat specifike të çdo OShC-je.
- Përfitimi i njohurive të thella dhe i informacionit nga 188



pjesëmarrës (128 femra dhe 60 meshkuj) që përfaqësojnë OShC nga Vlora, Gjirokastra, Berati, Divjaka, Roskoveci, Shkodra, Fieri dhe Lezha (përmes 8 sesioneve të trajnimit), për hartimin e projektpropozimeve të suksesshme, për ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave, për kodin fiskal dhe legjislacionin për OJF-të si dhe për programet dhe skemat e financimit të BE-së.

- Marrja e shërbimeve help desk në zyrat përkatëse të 29 OShC-ve në rajonet Shkodër e Vlorë, bazuar në nevojat e identifikuar nga studimi si dhe sipas nevojave të tyre specifike.
- Ndjekja e 23 sesioneve informuese nga 512 persona (të zyrave të QKB-ve të Vlorës e Shkodrës) për rolin dhe aktivitetet e QKB-së. Pjesëmarrësit u inkurajuan të përfshihen në aktivitete vullnetare, duke theksuar nevojën për të qenë qytetarë më aktivë, dhe të bëhen pjesë e ndryshimit që ata duan të shohin në komunitetet e tyre, duke marrë pjesë në vendimmarrjen lokale si pjesë e grupeve të synuara të cilave u përkasin. Të rinjtë studentë u inkurajuan të ngrenë organizatat e tyre, sepse kjo do t'u rrisë mundësitë për të financuar idetë e tyre. Midis pjesëmarrësve kishte të rinj nga shkollat e mesme të qytetit, nga universitetet e Vlorës dhe të Shkodrës, nga njësitë administrative rurale, prindër, mësues, përfaqësues të medias dhe të OShC-ve.
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore në Vlorë, si: me Qendrën Rinore Vlorë, me Agjencinë për Demokracinë Lokale, “Me komunitetin për ndryshim”, me drejtoritë e shkollave “Rilindja”, “Halim Xhelu”, Ali Demi, “Muco Delo”, “Pilo Prifti” Novosele, me njësitë administrative rurale të Qendrës së Orikumit, me zyrën





e Avokatit të Popullit, me zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Fier, me Këshillin Bashkiak Vlorë etj.

- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe OShC-të në Shkodër, të tilla si: drejtoritë e shkollave “28 Nëntori”, “Oso Kuka”, Shejaze Juka, “Luigj Gurakuqi” Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Ekonomike Shkodër, bashkitë Shkodër, Lezhë, Dibër, Pukë, Vau i Dejës, Malësi e Madhe etj.
- Adresimi në Bashkinë Vlorë i dy prej pesë prioriteteve të identifikuara dhe të advokuara nga rrjeti i OShC-ve Vlorë si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese të rrjetit. Kështu, është rritur buxheti për qiratë sociale nga 5 në 8.7 milionë, një rritje me 74%. Kjo rritje do të ndihmojë strehimin gjatë vitit 2020 të grave viktime të dhunës dhe grave të tjera me probleme ekonomiko-sociale. Një tjetër arritje advokuese është rritja e kohës së qëndrimit në kopshte dhe çerdhe për fëmijët deri në orën 17.00. Kjo do t’u japë mundësi grave të varfra dhe të divorcuara/të veja të punojnë në industrinë fashione dhe të kenë mundësi ta marrin fëmijën pas punës nga kopshti.
- Krijimi i dy komiteteve të reja të referimit të rasteve të dhunës (një në Himarë dhe tjetri në Selenicë), si rezultat i punës advokuese të QShPZh-së, Qendrës “Aulona” dhe Qendrës “Vatra” (OSHC në jug të vendit) - dy organizata si anëtare bashkë me institucionet e tjera shtetërore.
- Dalja e koordinatorëve të Vlorës dhe të Shkodrës në pesë transmetime në TV-të lokale dhe organizimi prej tyre i 6 takimeve me mediat lokale në Shkodër e Vlorë, me qëllim që të rrisin fizibilitetin e zyrave dhe aktiviteteve të tyre.
- Mbledhja rregullisht e OShC-ve brenda dhe jashtë ambienteve të QKB-ve dhe rrjetëzimi për të rritur ndikim e fushatave të tyre të advokimit. 10 takime me OShC-të kanë forcuar marrëdhënien midis tyre dhe zyrave përkatëse në Shkodër e Vlorë. Zyrat e QKB-ve kanë lehtësuar rrjetëzimet midis OJF-ve përmes takimeve formale dhe informale midis tyre. Qëllimi i takimeve ishte nxitja e OShC-ve për të rritur aktivizimin e tyre në rrjetëzime me njëra-tjetrën përmes aksioneve të përbashkëta. Rrjeti i OShC-ve në Vlorë ka diskutuar në takim dhe dytë për nevojat prioritare për shërbimet sociale për Bashkinë Vlorë, për të cilat është advokuar më vonë me sukses në Këshillin Bashkiak.
- Informimi i rreth 6200 përfituesve jo të drejtpërdrejtë për aktivitetin e zyrave të QKB-së, për thirrjet për projektpropozime dhe për mundësitë e rritjes së kapaciteteve të OShC-ve përmes mediave sociale të QShPZh-së.

### **Sfidat e projektit**

- OShC-të janë të varura gjerësisht nga financimet e donatorëve, prandaj qëndrueshmëria e tyre është në rrezik herë pas here, për sa kohë që ato nuk kanë aktivitete/shërbime për gjenerim të ardhurash.
- OShC-të nuk trajtohen në mënyrë të barabartë nga autoritetet shtetërore, veçanërisht




organizatat që janë kritike ndaj pushtetit vendor e qendror, nuk arrijnë të marrin asnjë lloj mbështetjeje financiare.

- Dialogu dhe konsultimet midis shtetit dhe shoqërisë civile trajtohen shpesh si një instrument thjesht formal.
- Aktorët e shoqërisë civile janë ende në fazën e “ndërtimit të kapaciteteve” për sa i përket angazhimit aktiv në proceset e hartimit të politikave në fusha social- ekonomike, veçanërisht për sa u përket qasjeve ndaj politikave të BE-së.
- OShC-të ende kanë nevojë të përmirësojnë kapacitetet dhe të kuptuarit e mekanizmave që duhet të përdorin për të ndikuar në proceset vendimmarrëse.
- Zbatimi i ligjit për vullnetarizmin dhe i ligjit për sipërmarrjet sociale do t’i japë një frymëmarrje më të gjerë zhvillimit të OShC-ve në Shqipëri.

# Projekti: Polici në shërbim të komunitetit për trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në Bashkinë Lezhë – SIDA

## Arritjet e projektit

- Përfshirja në sistemin e referimit të 10 anëtarëve të mekanizmit, të cilët përfaqësojnë institucionet nga vijë dhe kanë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë respektive.
- Harta e rasteve të dhunës në familje, prodhimi dhe ndarja e saj ndërmjet anëtarëve të mekanizmit.
- Trajnimi i 40 punonjësve të institucioneve respektive, anëtarë të mekanizmit të referimit, për detyrat specifike në lidhje me funksionimin e mekanizmit të referimit.
- Ndërgjegjësimi i 500 të rinjve në lidhje me dhunën dhe pasojat e saj në familje apo tek individët.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i 200 anëtarëve të komunitetit për funksionimin e mekanizmit të referimit të dhunës.



## Sfidat e projektit

- Gjatë zbatimit të projektit kemi ndeshur disa sfida, të cilat janë diskutuar ndërmjet specialistëve të policisë së zonës. Për shembull, specialistët e policisë pranojnë që format e reja të lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes nuk janë reflektuar në sistemin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Kjo sfidë gjen përgjigje në aktivitetet që rrisin kapacitetet e strukturave policore, shëndetësore dhe edukuese, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, si: komunikimi me viktimat e dhunës, ofrimi i ndihmës së parë dhe plotësimi i dokumentacionit për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes.

- Format ekzistuese për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes nuk përmbajnë masat e reja që kanë dalë pas amendimit të ligjit, së fundmi. Si rrjedhojë, specialistët e zonës kanë nevojë për më shumë trajnime dhe kualifikime në çdo komisarjat policie për të trajtuar rastet që kanë të bëjnë me minorenët dhe dhunën në familje. Kështu, përgjegjësia ndahet ndërmjet specialistëve të zonës dhe strukturave të tjera institucionale.



Kjo sfidë korrespondon me fuqizimin e strukturave përgjegjëse dhe punonjësve të forcave të policisë për të rritur efektivitetin që të reagojnë në momentin e duhur, përmes trajnimeve për mekanizmat e referimit, ndryshimeve të fundit në ligj për dhunën në familje dhe udhëzimit për vlerësimin e riskut.

- Sfidë tjetër është mungesa e besimit nga ana e komunitetit për forcat e Policisë së Shtetit.

Kjo sfidë është adresuar përmes pjesëmarrjes së specialistit të zonës në takime të përbashkëta me komunitetin, me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit në komunitet duke informuar pjesëtarët e komuniteteve lokale për të drejtat e tyre, për mekanizmat e referimit dhe për detyrat e specialistëve të zonës në rastet e dhunës në familje apo të asaj me bazë gjinore.



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh) falenderon të gjithë donatorët për besimin dhe bashkëpunimin me shoqatën. Pa mbështetjen e tyre do ta kishim të vështirë zbatimin e projekteve dhe përmbushjen e objektivave. Arritjet janë një motiv nxitës për shoqatën dhe rritin vetëbesimin se stafi është i aftë të ndërmarrë punë edhe më të vështira dhe të përballet me profesionalizëm e përkushtim me sfidat që na presin.

Gjithashtu, QShPZh-ja falënderon bordin drejtues, bordin këshillimor dhe stafin për kontributin dhe punën e vyer që kanë bërë për të pasur një vit të suksesshëm si viti 2019. Arritjet tona dhe kapërcimi i sfidave kanë në themel të tyre dhe angazhimin e dhjetëra e qindra aktivistëve, të rinjve, grave, intelektualëve, si dhe bashkëpunimin e frytshëm me institucionet shtetërore (veçanërisht me ato të shëndetësisë e të arsimit), me median, me shoqërinë civile etj.





**Brunilda Hylviu**  
*Drejtoresh e Ekzekutive*



**Ermira Zace**  
*Oficere financiare*



**Enela Mone**  
*Menaxhere e Qendrës  
"Aulona"*



**Juna Mali**  
*Asistente Administrative  
dhe Kordinatore Projekti*



**Blerina Shehu**  
*Kordinatore Projekti*



**Andi Rabiaj**  
*Kordinator Projekti*



**Arbana Dibra**  
*Kordinatore Projekti*

## QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN

---

### RAPORTI VJETOR 2019

- Email: [info@acpd.org.al](mailto:info@acpd.org.al)
- Web: [www.acpd.org.al](http://www.acpd.org.al)